



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës-Presednik Opštine-Municipal Mayor

Njësia e Auditorit të Brendshëm



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



Raporti vjetor i Njësies së Auditimit të Brendshëm Janar-Dhjetor 2018

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odelenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 2130 Me 09.07.2019
Br. prot. Dt.

RAHOVEC - ORAHOVAC

I Pjesa e përgjithshme	
1. Të dhënat e përgjithshme për shfrytëzuesin e buxhetit (Subjektin e sektorit publik)	
Subjekti sektorit publik (SSP):	Komuna e Rahovecit
Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:	Smajl Latifi
Emri dhe mbiemri i Drejtorit/Auditorit të NjAB:	Binak Kryeziu
Telefoni: 044-128-286	E-mail: binakkryeziu@hotmail.com Binak.kryeziu@rks-gov.net
Qëllimi i raportit gjashtëmuor/vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm: Raportimi tek Ministria e Financave – Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm lidhur me auditimet e kryera dhe aktivitetet e auditimit të brendshëm si dhe të dhënave të nevojshme për përpilimin e raportit unik (përmbledhës) gjashtëmuor/vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik.	
Roli dhe qëllimi i auditimit të brendshëm: “Auditimi i brendshëm” është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të përmbushë objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrolleve dhe qeverisjes.	
2. Të dhënat për Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe auditorët e brendshëm	
2.1 Njësia e Auditimit të Brendshëm është themeluar sipas Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike	PO
2.2 Nëse përgjigja është JO – thekso arsyet	
2.3 Njësia e auditimi i brendshëm është themeluar sipas njërës nga mënyrat si në vijim:	

a) Njësi e pavarur të auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejt të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik; b) Njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Financave; c) Njësi e marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër, me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo d) Njësi kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.		
2.4 Njësia e auditimit të brendshëm në mënyrë organizative i përgjigjet drejtpërsëdrejti dhe ekskluzivisht Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik		PO
2.5 Nëse përgjigja është JO – thekso kujt i përgjigjet dhe arsyet:		
2.6 A është plotësuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas kërkesave ligjore		PO
Kërkesat minimale ligjore për numrin e auditorëve	Numri aktual i auditorëve	Burimet e nevojshme për auditim
2.7 Nëse përgjigja është JO – atëherë thekso arsyet për mos plotësimin e njësisë me numrin minimal të auditorëve sipas kërkesave ligjore:		
2.8 Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm dhe auditorët e brendshëm a janë të çertifikuar sipas kushteve të parapara me ligj:		PO
2.9 Nëse përgjigja është JO thekso arsyet:		
2.10 Auditorët e brendshëm kryejnë vetëm punët e auditimit të brendshëm:		PO
2.11 Nëse përgjigja është JO – atëherë duhet theksuar cilat punë i kryen dhe cilat janë arsyet:		
2.12 Auditorët e brendshëm kanë qasje të plotë, të lirë dhe të pakufizuar te:		
a) Të gjithë dokumentacioni:		PO
b) Të dhënat dhe informatat tek të gjithë bartësit e të dhënave:		PO
c) Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik:		PO
d) Personeli (udhëheqësi dhe të punësuarit):		PO
e) Pasuria materiale:		PO
2.13 Nëse përgjigja është JO – duhet theksuar arsyet:		
Buxheti i subjektit të sektorit publik		

2.14 Paga dhe rrogat	
2.15 Mallra dhe shërbime	
2.15.1 Shpenzimet komunale	
2.16 Subvencione dhe transfere	
2.17 Kapitale	
Gjithsej buxheti	
2.18 Njësia e auditim të brendshëm ka buxhetin e ndarë	JO
2.19 Nëse përgjigja është PO - sa është buxheti i saj	
2.20 Nëse përgjigja është JO - në cilin departament është i vendosur buxheti i Njesisë së auditimit të brendshëm: Në Zyren e Kryetarit	
3. Zbatimi standardeve dhe metodologjisë së punës së Auditimit të Brendshëm	
Zbatimi i Doracakut të auditimit të brendshëm	
3.1 Auditorët e brendshëm kanë një ekzemplar të Doracakut të auditimit të brendshëm:	PO
3.2 Auditorët e brendshëm, përpos Doracakut të auditimit të brendshëm kanë edhe shtesën e vet të doracakut për auditim të brendshëm	PO
3.3 Nëse përgjigja është PO – a është kërkuar pëlqimi të NjQH/AB për shtesën e doracakut:	PO
3.4 Nëse përgjigja të pika 3.3 është JO – të theksohen arsyet	
3.5 Auditorët e brendshëm në kryerjen e auditimeve të veçanta/me kërkesë u përmbahen në tërësi fazave të proceseve të auditimit të përcaktuara me Doracakun e auditimit të brendshëm	PO
3.6 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:	
Statuti i auditimit të brendshëm	
3.7 Njësia e auditimit të brendshëm ka statutin e auditimit të brendshëm	PO
3.8 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:	
3.9 Statuti i auditimit të brendshëm është i nënshkruar nga Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Drejtori i Njesisë së AB:	PO
3.10 Nëse përgjigja është Po – shkruaj datën e aprovimit të statutit	
Zbatimi i kodit të etikës profesionale të AB	
3.11 Auditorët e brendshëm i përmbahen parimeve dhe rregullave të përcaktuara me Kodin e etikës profesionale:	PO
3.12 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet dhe rastet e mos përmbajtjes:	
Kryerja e auditimit të brendshëm	
3.13 Plani strategjik i auditimit të brendshëm është përpiluar në bazë të vlerësimit të rrezikut:	PO
3.14 Nëse përgjigja është JO – theksoni arsyet:	
3.15 Planin strategjik të auditimit të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të	PO

sektorit publik dhe Komiteti i auditimit						
3.16 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.17 Planin vjetor të AB është hartuar në bazë të Planit strategjik të AB:						PO
3.18 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.19 Planin vjetor të AB të brendshëm e ka miratuar Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe Komiteti i auditimit:						PO
3.20 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
3.21 Subjekti i sektorit publik ka themeluar Komitetin e Auditimit						PO
3.22 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:						
Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm						
3.23 Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale)						
Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuara për angazhim	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
Gjashtëmujori I	5	16	2	5	80	2
Gjashtëmujori II	5	16		5	80	
Vjetore	10	32		10	160	
3.24 Arsyet për mos kryerjen e auditimeve sipas numrit të planifikuara të auditimit të brendshëm – theksoni arsyet:						
3.25 Auditimet e planifikuara dhe realizuar me kërkesë të Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik						
Numri i auditimeve të planifikuara me kërkesë	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuara për angazhim	Numri i auditimeve të realizuara	Koha shpenz. për auditimin me kërkesë	Numri i auditorëve të angazhuar	
1	11	2	1	11	2	
3.26 Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet finale të auditimit menjëherë pas kryerjes së AB						PO
3.27 Nëse përgjigjja është JO – Theksoni si i dërgohen Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik raportet finale të auditimit:						
a) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen të gjitha raportet e auditimit në fund të periudhës raportuese;						
b) Udhëheqësit të subjektit të sektorit publik i dërgohen raportet e auditimit kohë pas kohe;						

c) Në mënyrë tjetër (theksoni si)	
3.28 Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik përpilon dhe vendos për planin e veprimit i cili përfshinë rekomandimet e pranuar dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren në pajtim me ligjin për KBFP	PO
3.29 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:	
3.30 Për rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit njësia për auditimit të brendshëm ka bazën e organizuar të dhënave për zbatimin e rekomandimeve:	PO
3.31 Nëse përgjigjja është JO – theksoni arsyet:	
3.32 Rekomandimet e dhëna përcjellën sipas planit të veprimit, ashtu sikur është përcaktuar me doracak të auditimit të brendshëm	PO
3.33 Nëse përgjigjja është JO – thekso arsyet:	
Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:	
3.34 Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	52
3.35 Numri i rekomandimeve të zbatuara:	31
3.36 Numri i rekomandimeve në proces:	21
3.37 Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	
3.38 Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit:	
II Pjesa e veçantë	
1. Pasqyra e auditimeve të kryera dhe ndryshimi nga plani vjetor i auditimit, duke theksuar arsyet e ndryshimit ose moskryerjes së auditimeve të planifikuara	
Thekso të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese me të gjeturat dhe rekomandimet, dhe drejtimi i shkurt për secilin auditim.	
1.1 . Emërtimi i auditimit:	
Auditimi i brendshëm në Drejtorin e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.	
Të gjeturat (përshkruaj të gjeturat)	
2. REZULTATET	
3.1. Pajtueshmëria me ligjet dhe legjislacionin në fuqi, Objektivi kryesor i auditimit	
Mbështetur në materialitetin e sistemit të përcaktimit të tarifave nga taksat dhe arkëtimi i të hyrave vetanake në planifikimin ton të auditimit kemi parapa të auditojmë sistemin planifikimit të të hyrave vetanake, përshtatshmëria e arkëtimeve me tarifat e miratuara, grumbullimin e të hyrave vetjake, dhe	

objektivat e kontrollit të sistemit të dizajnuara nga Menaxhmenti, vlerësimin dhe identifikimin e rreziku dhe efikasiteti dhe efektiviteti në monitorimin e këtij sistemi.

Objekti ynë i kontrollit është për të siguruar efikasitetin, dhe efektivitetin e kontrollit në menaxhimin e këtij sistemi për të siguruar dhe formuar një opinion lidhur me funksionimin apo mjaftueshmërinë e tij në menaxhimin dhe kontrollin e këtij sistemi për të i ofruar siguri Menaxhmentit të audituar lidhur me funksionimin apo mos funksionimin e kontrollit në këtë drejtim.

3.2. Sistemi i kontrollit të brendshëm i të hyrave , ekziston dhe funksionon.

3.2.1. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit

Drejtorja e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit ngarkohet për realizimin e të hyra nga Taksat për lëshimin e lejeve për Ndërtim, Përdorim, prishje të objekteve ndërtimore dhe taksat për rregullimin e tokës ndërtimore , në bazë të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr. 1076 të datës 27.03.2015, (Nenit 4 dhe 5).

Rregullorja e re për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr. 576 të datës 28.02.2017, realizohen të hyrat nga Taksat për lëshimin e lejeve për Ndërtim, Përdorim, prishje të objekteve ndërtimore, dhe taksat për rregullimin e tokës ndërtimore, (Neni 4 dhe 5). Dhe ,

Rregullorja për dhënien e lejeve mjedisore komunale (LMK) nr. 906 të datës 30.03.2016.

Në kemi kryer testimin e 80% të mostrës në tërë transaksionin në vlera të ndryshme , të cilat lidheshin më të hyrat nga lejet dhe të tjera të cekura më lartë. Kemi bërë vlerësimin dhe rishikimin e procedurave mbi realizimin e të hyrave vetjake, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.

Çështja 1- Respektimi i Rregullorës – proritëti i lartë.

Të Gjeturat:

Me Rregulloren e re kishte ndryshime, ishin shlyer taksat për kushtet ndërtimore, lokacioni hapsinor dhe leje e përdorimit.

Nuk është respektuar Rregullorja e re nr. 576 të datës 28.02.2017, taksat për kushteve ndërtimore dhe për lokacionin hapsinor, ju është kërkuar pagesa e taksave sipas Rregullorës të ç'fuqizuar gjërë me datën 25.04.2017.

Çështja 1.1. – Mosefikasitet në inkasimin e të hyrave vetjake – Prioritet i lartë

Drejtorja e audituar për vitin 2017 kishte realizuar vetëm 30.001,67€ të hyra apo 31,18% nga planifikimi prej 96.232,00€. Kurse për gjashtëmuorshin e dytë kishte realizuar 12.116,84€ të hyra apo 12,60%, dhe në muajin Janar – Shkurt të vitit 2018, ishin bërë vetëm dy pagesa për leje ndërtimi në vlerë prej 874,53€, dhe për leje mjedisore komunale ishin bërë pesë pagesa në vlerë prej 290,00€.

Si më poshtë paraqesim tabelat e kërkesave dhe vlerën e të hyrave:

Tabela nr.1 Të hyrat Janar – Dhjetor -2017

Nr.					
-----	--	--	--	--	--

Ren.	EMËRTIMI	Kërkesat	Të Aprovuara	SH / R / C	Shuma €
1	Taksat Administrative				159,00
2	Leje Ndërtimi (Parallogaria)	45	39	4 / 2	26.422,06
3	Kushtet Ndërtimore	65	52	5 / 3 / 5	320,00
4	Leje Rrërimi	10	9	1	10,00
5	Vazhdimi i lejës	1	1		/
6	Shkresë	58	56	2	/
7	Aktvendim	26	23	1 / 2	90,00
8	Pelqim	38	31	2	
9	Ankesa	2	1	1	
10	Leje Mjedisore Komunale	26		7	2.968,01
	TOTALI				29.969,07

Tabela nr.2

Të hyrat Korrik – Dhjetor -2017

Nr. Ren.	EMËRTIMI	Kërkesat	Të Aprovuara	SH / R	Shuma €
1	Taksat Administrative				50,00
2	Leje Ndërtimi (Parallogaria)	27	24	3	11.075,86
3	Kushtet Ndërtimore	23	18	3 / 2	/
4	Leje Rrërimi	3	2	1	
5	Shkresë	22	23		
6	Aktvendim	5	5		5,00
7	Pelqim	4	4		
8	Ankesa	2	1		
9	Referenca	2	2		
10	Leje mjedisore komunale	16	10	6	537,12
	TOTALI				11.667,98

Tabela nr. 3

Të hyrat Janar - Shkurt -2018

Nr. Ren.	EMËRTIMI	Kërkesat	Të Aprovuara	SH / R	Shuma €
1	Taksat Administrative				
2	Leje Ndërtimi (Parallogaria)	2	2		874,53
3	Kushtet Ndërtimore				
4	Leje Rrërimi				5,00
5	Shkresë	2	1		
6	Aktvendim	1	1		5,00
7	Pelqim	1	1		

8	Ankesa				
9	Referenca				
10	Leje mjedisore komunale	13	12	/ 1	290,00
	TOTALI				1.174,53

Sipas numrit të kërkesave për Leje Ndërtimi dhe kushteve ndërtimore e të tjera të paraqitura në tabelën nr. 1, 2 dhe 3 të marra nga raportet të Drejtorisë të audituar për vitin 2017, gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të parë të vitit 2018, kishte kërkesa minimale, gjë që ka ndikuar në të hyrat minimale.

Vërtetohet se ka një trend në ulje në inkasimin e të hyrave vetjake krahasuar me vitin paraprak dhe me planin e këtij viti. Në vitin e paraprak (viti 2017) realizimi i të hyrave ishte për 60,73% me pak se sa në vitin 2016.

Konkluzioni

Realizimi i ulët i të hyrave krahasuar me planifikimin rrezikon ngecjen në realizimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake dhe mos përmbushjen e objektivave të Komunës.

Çështja 2 – Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave - prioritet i mesëm

. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake në raport me Zyrtarin e të hyrave vetanake të komunës. Çështje më rëndësi

a)Për të siguruar se zyrtari i të hyrave vetanake në baza mujore procedon krahason dhe harmonizon informacionet e të hyrave të entitetit të audituar me zyrtarin komunal të të hyrave.

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Të Gjeturat

Me pas në mënyrë të detajuar i paraqesim si më pas procedurat e krahasimeve dhe harmonizimeve .

Sipas raportit të zyrtarin komunal të të hyrave, Drejtoria e audituar për vitin 2017 kishte realizuar vetëm 30.001,67€ të hyra apo 31,18% nga planifikimi prej 96.232,00€. Kurse për gjashtëmujorshin e dytë kishte realizuar 12.116,84€ të hyra apo 12,60%. Sipas raportit të Zyrtarit të të hyrave pranë Entitetit të audituar kishte realizuar 29.969,07€.

Zyrtarit i të hyrave pranë Entitetit të audituar në baza mujore ka harmonizuar dhe barazuar të hyrat vetanake me zyrtarin e të hyrave komunale në mënyrë të dokumentuara dhe në formë të shkruar.

Ishte një mos harmonizim dhe barazim në një shumë të vogël prej 32,60€.

3.3. Taksa për lëshimin e lejeve për ndërtim, përdorim, prishje të objekteve ndërtimore.

3.3.1. Leje për Ndërtim

- Në bazë të Rregullorës 01 Nr.1076 të datës 27.03.2015, dhe Rregulloresa se re nr. 576 të datës

28.02.2017 Ligji për Planifikimi Hapsinor nr. 04/L-174, Ligji për Ndërtim nr. 04/ L-110 dhe Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive.

Procedura e përgjithshme për lëshimin e lejes ndërtimore

Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I, dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III.

Sipas një regjistri në Drejtoria e audituar, në vitin 2017 me qëllim të pajisjes me leje ndërtimi kishin aplikuar gjithsej 45 aplikues. Prej këtyre kërkesave, vetëm 39 aplikacione ishin shqyrtuar si pozitive, 4 prej tyre ishin në procedurë e sipër (shqyrtim),

Çështja 3 - Lejet e ndërtimit – Prioritet i lartë

Të Gjeturat

Drejtoria e audituar nga lejet e ndërtimit gjatë vitit 2017 kishte planifikuar që të realizoj shumën prej 40.232,00€, ndërsa kishte inkasuar vlerën prej 26.422,06€ (65,67%). Ne kemi testuar të gjitha mostrat dhe kemi identifikuar se ka pasur shumë pak kërkesa për leje ndërtimi. Kjo tregon në mos azhuritetin e Inspekcionit, që vërtetohet se është bërë pak në kalkulim të vlerës financiare të sipërfaqeve të objekteve për të cilin është dhënë leja e ndërtimit.

Konkluzioni

Inkasimet jo të kënaqshme të të hyrave, faturimi më i ulët dhe vonesat në vendimet për dhënien e lejeve ndërtimore reduktojnë të hyrat dhe si pasojë rrezikojnë arritjen e objektivave të Komunes.

E gjetura

Me rastin e dhënies së lejes së ndërtimit për një objekt, kishte pasur vonesë me pajisjen e lejes më gjatë se 30, respektivisht 45 ditë nga aplikimi sipas ligjit për ndërtimet 04/L-110. Kërkesa për aplikim ishte më 15.05.2017, ndërkaq leja e ndërtimit është dhënë pas pesë muajve, më 03.11.2017. Gjatë ekzaminimit fizik, konstatoam që gjatë kësaj periudhe, objekti ishte ndërtuar, ndërsa komuna, respektivisht drejtoria e inspektoriatit nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim ndalese, dhe si rrjedhojë, nuk dihet nëse janë respektuar kushtet ndërtimore.

Konkluzioni

Mungesa e inspektimeve të objekteve ndërtimore nga komuna, rrit rrezikun që të bëhen keqpërdorime gjatë ndërtimit në kundërshtim me kushtet urbanistike dhe mos realizimin e të hyrave të planifikuara nga kjo veprimtari.

3.4. Kushtet Ndërtimore

Ligji nr. 03/L- 106 për ndryshim të ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003-14

Neni 27.2. Organi kompetent Komunal ose do të lëshoj kushte ndërtimore , ose do të refuzoj atë duke përfshirë shqarim me shkrim të arsyeve të refuzimit brenda 21 diteve nga dita e pranimit të kërkesës për lëshimin e lejes së ndërtimit.

Sipas një regjistri në Drejtorin e audituar, në vitin 2017 me qëllim të pajisjes me Kushte ndërtimore kishin aplikuar gjithsej 65 aplikues. Prej këtyre kërkesave vetëm 52 aplikacione ishin shqyrtuar si pozitive, 5 prej tyre ishin në procedurë e sipër (shqyrtim), 3 lënd janë refuzuar,

Për të siguruar kushte ndërtimore duhej shoqëruar me dokumentacion të kompletuar teknik, konform nenit 37 të këtij Ligji.

Me ç'fuqizimin e Rregullores të vitit 2015, në bazë të Rregullores së re të vitin 2017, është shlyer taksa për kushte ndërtimore

Kërkesat ishin gjërë me datën 25.04.2017, në gjashtëmujorshin e dytë të vitit 2017, nuk kishte kërkesa për aplikim.

Sipas raportit të Drejtorisë të audituar konstatohet se kishte pak kërkesa për kushte ndërtimore.

Të hyrat për kushte ndërtimore ishin minimale. shuma e inkasuar ishte në vlerë prej 320,006.

Me Rregullorja e re për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr. 576 të datës 28.02.2017, kushtet ndërtimore janë shlyer, nuk janë aplikuar taksat për kushte ndërtimore.

3.4. Zbatimi i taksës për dhënjën e lejes Mjedisore Komunale,

Rregullorja për dhënien e lejeve mjedisore komunale nr. 906 të datës 30.03.2016.

Neni 9

Brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës me raport të LMK- së dhe në bazë të vlerësimit për miratim apo refuzim nga komisioni profesional, zyrtari/ja i/e mjedisit harton miratimin apo refuzimin për leje mjedisore komunale dhe akti nënshkruhet nga Drejtori i Drejtorisë.

Sipas një regjistri në Drejtorin e audituar, në vitin 2017 me qëllim të pajisjes me leje mjedisore komunale kishin aplikuar gjithsej 26 aplikues. Prej këtyre kërkesave, vetëm 19 aplikacione ishin shqyrtuar si pozitive, dhe 7 ishin refuzuar,

Në gjashtëmujorshin e dytë të vitit 2017 me qëllim të pajisjes me leje mjedisore komunale kishin aplikuar gjithsej 16 aplikues. Prej këtyre kërkesave, vetëm 10 aplikacione ishin shqyrtuar si pozitive dhe 6 ishin refuzuar.

Në Janar dhe Shkurt të vitit 2018 me qëllim të pajisjes me leje mjedisore komunale kishin aplikuar gjithsej 13 aplikues. Prej këtyre kërkesave, vetëm 12 aplikacione ishin shqyrtuar si pozitive dhe 1 ishin refuzuar.

Çështja 5 - Taksat për dhënjën e lejes Mjedisore – prioritet i mesëm.

Të Gjeturat

Drejtorin e audituar nga lejet mjedisore komunale gjatë vitit 2017 kishte planifikuar që të realizoj shumën prej 6.000,00€, ndërsa kishte inkasuar vlerën prej 3.193,58€ (53,23%). Kurse në muajin Janar dhe Shkurt inkasimi ishte 290,00€. Ne kemi testuar të gjitha mostrat dhe kemi identifikuar se ka pasur

shumë pak kërkesa për leje mjedisore.

Konkluzioni

Sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon vendosje të udhëzimeve dhe procedurave të qarta të kontrolleve. Kontrollat e brendshme duhet të rishikohen dhe të përshtaten, ngase siç funksionojnë në formën aktuale, ofrojnë sigurinë e duhur se objektivat e përcaktuara të Drejtorisë po arrihen.

3.4. Rishikimet në menaxhimin financiar të kontrollit, vendimmarrjet (objektivat specifike)

Çështja 6 - Menaxhimi, kontrolli dhe qeverisja – Prioritet i lartë

Përshkrim

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një proces gjithë përfshirës i të gjitha aktiviteteve të entitetit të audituar i cili zbatohet dhe jetësohet nga Menaxhmenti dhe personeli i tjië i angazhuar në të gjitha sistemet dhe nën sistemet.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon nëse menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat.

Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga Drejtoria e audituar të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve

3.5. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut në menaxhimi administrativ dhe financiar të sistemit.

Çështja 7 -Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut çështje më prioritet të lartë.

Te gjeturat

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut, vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në forma të dokumentuar dhe të shkruar, mos ekzistimin e një regjistri të riskut me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara.

Konkluzion

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëloj performancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së performancë së suksesit të mësimëve

Rekomandimet (përshkruaj rekomandimet, të cilat kanë të bëjnë me të gjeturat e përshkruara)

Rekomandimi - 1

Rekomandojmë Drejtorin e audituar duhet të analizoj arsyet me trend të ultë në realizimin e të hyrave, gjatë viteve të fundit dhe në bazë të kësaj të bëjë një planifikim objektiv dhe të realizueshëm.

Rekomandimi - 2

Drejtoria e audituar duhet të sigurojë një plan konkret i cili do të rriste shkallën e realizueshmërisë së të hyrave. Plani i tillë duhet të sigurojë se respektohen afatet kohore në lidhje me rrjedhat e të hyrave.

Rekomandimi - 3

Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë bashkëpunim më të mirë me Drejtorin e Inspektionit për rritjen e inkasimit të të hyrave, të marrë në konsiderat të nevojat reale të Drejtorisë.

Rekomandimi - 4

Menaxhmenti i entitetit të audituar me pranimin e përgjegjësisë të deleguara nga Drejtoria e audituar kërkohet të projektojë dhe të hartojnë një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut, vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në formë të dokumentuar dhe të shkruar.

Përmbajtja e shkurt drejtuese (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2.1. Objektivat kryesore:

1. Pajtneshmëria me ligjet dhe legjislacionin në fuqi,
2. Sistemi i kontrollit të brendshëm i të hyrave dhe shpenzimeve, ekziston dhe funksionon.
3. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit
4. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave vetanake
5. Zbatimi i Taksës për lëshimin e lejeve për ndërtim, përdorim, prishje të objekteve ndërtimore,
6. Zbatimi i taksës për dhënjën e lejes Mjedisore Komunale,
7. Zbatimi i Lartësisë të tarifës për rregullimin e tokës ndërtimore.

2.2. Fushëveprimi i këtij Auditimi është si në vijim:

Fushëveprimi i Auditimit është gjashtëmujorshi i dytë të vitit 2017, dhe dymujorshi i parë të vitit 2018

duke përfshir të gjitha dokumentët që kanë të bëjnë me grumbullimi i të hyrave nga taksat për lëshimin e lejeve për ndërtim, kushtet ndërtimore, përdorim, prishje të objekteve ndërtimore, identifikimin e raporteve, vendimeve, aktvendimeve, shërbimeve, pagesat dhe barazimin.

Perioda e auditimit 02.02 gjërë 01.03.2018.

Lokacioni: Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.

1.2 . Emërtimi i auditimit:

Auditimit i Brenshëm Ad-Hoc në Drejtorin Komunale të Arsimit

Të gjeturat:

1.1. Rezultatet e auditimit

Në këtë kapitull janë prezantuar të gjeturat kryesore të auditimit të cilat ndërlidhen me Drejtorin Komunale të Arsimit, përgjegjëse për sigurimin e bazës ligjore, në nivel lokal të përzgjedhura për auditim.

Me gjithë zhvillimet në drejtim të një menaxhimi më të mirë brenda Drejtorisë të audituar dhe Shkollave të Komunës ngecjet janë evidente në zbatimin e ligjit, mos planifikimi dhe mos zbatimi i kërkesave ligjore gjatë dhënies të Aktvendimeve, Vendimeve dhe vërtetimeve punëtoreve të dalur në pension.

Çështja – 1 Lëshimi i Aktvendimit - Vendimet për Pensionim- Prioritet i lartë.

Gjetjet tona të auditimit në këtë drejtim në Drejtorin e audituar dhe me dealjen në teren nëpër shkolla në këtë drejtim tregojnë se kemi hasë Aktvendimet e lëshuara për pensionim , Vendime dhe Vërtetime të lëshuara.

- Gjatë rishikimit Aktvendimet - Vendimet e lëshuara për pensionim kishin bazë Juridike ligjore. Në bazë të ligjit në fuqi ku është theksuar tekstativisht në Nenin 67 ndërprehet kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, pika 1.4. kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç; (Ligji nr. 03/L-212).

Konstatohet se janë lëshuar dy lloje të dokumenteve Vendim dhe Aktvendim për daljen në pension.

Çështja - 2 Lëshimi i vërtetimeve për stazhin e punës. – prioritet i lartë.

- Gjatë rishikimit Vërtetimet e lëshuara për vitet e 90-ta (1989-1999 vit), pjesërisht kishin bazë juridike ligjore.

Bazuar në Ligjit në fuqi nr. 03/L-040, ku është theksuar tekstativisht në Nenin 62, paragrafi 3. Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

Dhe, Në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit nr. 01/Nr. 569/11 të datës 16.02.2010, ku është theksuar tekstativisht në Nenin 57, Kryetari i Komunës është udhëheqës i degës ekzekutive të komunës dhe zgjedhës i drejtpërdrejt nga qytetarët me te drejt vote.

Kurse në fund të vërtetimit ku është theksuar tekstativisht Vërtetimi lëshohet me kërkesën e punëtorit dhe shërben për të dëshmuar stazhin e punës në Ministrin e Punës dhe Mirqeniesë Sociale, me Qëllim të realizimit të drejtës në pension kontribut pagues sipas Ligjit 04/L-131, për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Të Gjeturat:

Konstatohet se në Vërtetim nuk është cekur Neni 8 pika 6 të Ligjit 04/L-131, ku cekët:

Në Nenin 8 kushtet dhe kriteret për njohje e të drejtës në pension kontributpagues të moshës, pika 6 me këtë ligj u njohet stazhi i punës për pension kontributdhëns për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar ne sistemin e Republikës së Kosovës.

Gjatë rishikimit të listës së pagave është vërtetuar se punëtorëve pensionist ju është i njohur stazhi i punës të viteve 90-ta.

Rekomandimet:

REKOMANDIMI – 1

Rekomandojm që në të ardhmen të lëshohet një dokument unik Vendim ose Aktvendim, për formën e shkresave, të kujdeset zyra ligjore.

REKOMANDIMI – 2

Rekomandojm që Ligji 04/L-131 , Neni 8, Pika 6 të vendoset në klauzolën e pjesës hyrse të Vërtetimit.

Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshekruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

Objektivi i Auditimit:

1. Verifikimi i Vendimeve, Aktvendimeve dhe Vërtetimeve në Dosje të Punëtorëve.
- 2.

Fushveprimi: viti 2017.

Periudha e auditimit: 20.03 gjërë 28.03.2018

1.3 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Punë Inspektuese.

Të gjeturat:

2. REZULLTATET

2.1. TË GJETURAT DHE REKOMANDIMET KRYESORE TË AUDITIMIT

2.1.1. Sistemi i kontrollit të brendshëm për zbatimin e taksave për shërbime inspektuese , ekziston dhe funksionon.

Auditimi ynë është fokusuar në rishikimin e prezantimit dhe shpalosjeve të punëve inspektuese dhe në kryerjen e testeve substanciale për të konfirmuar saktësinë dhe validitetin e të hyrave vetanake.

Menaxhmenti duhet të garantoj ekzistimin e aktiviteteve të kontrollit dhe që ato po ndërmerren në lidhje me proceset që janë nën kontrollin e tyre. Ata janë përgjegjës për aplikimin e kontrolleve të mjaftueshme për të siguruar që rreziqet të minimizohen në nivel të pranueshëm.

Objektivi kryesor i Drejtorisë për punë Inspektuese është:

- Të sigurohet që të gjitha të hyrat të regjistrohen dhe të barazohen në mënyrën e duhur dhe të jenë të auditueshme.
- Përcjellja e raporteve periodike dhe vjetore.
- Të sigurohet që ti plotësojnë obligimet e tyre në punët inspektuese.
- Implementimi i të gjitha rekomandimeve të dala nga auditori i brendshëm.
- Të sigurohet që të gjitha të hyrat të mbledhen sipas bazës ligjore.
- Të ngritet niveli i bashkëpunimit për ngritje të efikasitetit për shërbimet inspektuese.
- Dhe të tjera.

TË GJETURAT

Janë kryer rishikime të hollësishme mbi besueshmerin e procedurave të kryera në raporte të punës nga burimet sakta në këtë Drejtori.

Përkundër përmirësimeve të ndjeshme, sistemi i kontrollit të brendshëm mund të përmirësohet edhe më shumë, në veçanti janë identifikuar dobësi tek përdorimi i mos barazimeve çka do të pamundësonte plotësinë e të hyrave që ato të verifikohen se janë të sakta gjatë auditimit.

Në bazë të raportit të punës dhe raportit vjetor kan bërë evidentimin e procesverbaleve për çdo drejtim veç e veç, mirpo procedurat për trajtimin e inkasimit të të hyrave konsiderohen si

jo adekuate, sidomos mospërcjellja e harmonizimeve të të hyrave në përgjithësi. Këto çeshtje janë rezultat i rishikimit analitik të auditimit. Lidhur me regjistrimin e të hyrave vetanake në këtë Drejtori.

KONKLuzioni

Kontrolli i brendshëm duhet të jetë më azhur në regjistrimin e dokumenteve zyrtare në forma raportuese që të posedojn evidenca të sakta mbi të hyrat vetanake gjë që mund të rezultojë në raportim të pasaktë në pasqyrat financiare. Këto dobësi rrisin rrezikun e gabimeve dhe parregullsive në inkasimin e të hyrave

2.1.2. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit

Drejtoria për punë inspektuese realizon të hyra nga taksat për shërbime inspektuese.

Në bazë të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr. 1076 të datës 27.03.2015,

Rregullorja e re për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nr. 576 të datës 28.02.2017, (Neni 11)

sës për shërbime inspektuese

Nr. Ren.	EMËRTIMI	VLERA
1	Kërkesë për kontroll inspektues për persona fizik	10,00€
2	Kërkesë për kontroll inspektues për subjekte afariste	20,00€
3	Kërkesë për pëlqim pune	15,00€
4	Kërkesë për asgjësim mallrash	15,00€
5	Kërkesë për daljen në teren për PTK-në, KED S-in	100,00€
6	Kërkesë për daljen në teren për KRU Radoniqi, Ambienti	50,00€
7	Kontroll të therjeve të Gjedheve (Inspektor veterinar) në thertore të licencuara nga AUV për krerë.	5,00€

Çështja 1- Respektimi i Rregullorës – proritët i lartë.

- Zbatimi i Taksës për shërbime inspektuese

Të Gjeturat:

Këto të hyra kanë të bëjnë me të hyrat nga taksat administrative,

Të hyrat në drejtorin për punë inspektuese inkasohen vetëm nga taksat administrative për fletkërkesa.

Të hyrat e planifikuara sipas buxhetit fillestar për gjashtëmujorshin të vitit 2017 ishin 6.000,00€, kurse realizimi ishte 1.243,00€, (20,72%).

Të hyrat e planifikuara sipas buxhetit fillestar për dymujorshin të parë të vitit 2018 ishin 6.000,00€, kurse realizimi ishte 494,50€, (08,24%)

Totali i të hyrave për tetëmuaj ishte 1,737,50€.

Shumica e të hyrave nga inspektimi inkasohen në Drejtorin për Urbanizem,

Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorin për Shërbime Publike e tjera.

Të dhënat janë ekzaminuar sipas raportit të punës të Inspektoreve për gjashtëmujorshin e dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të parë të vitit 2018, si më poshtë:

Inspektori i ndërtimtarisë- (H.E).

Sipas Raportit të gjashtë mujorshit të dytë të vitit 2017 dhe Dymujorshit të parë të vitit

2018 Inspektori i Ndërtimit kishte planifikuar 262, Proqesverbalet të Realizuara për ndërtim ishin- 316, dhe për komunikacion ishin 275, Aktvendimet ishin- 41, Fletëparaqitjet ishin -24, Njoftimet dhe Kërkesat- 28, Ftesat Kërkesat Konkluzat ishin 4 dhe Flet paraqitjet ekzekutuara ishin 6

Çështja 1 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Nga Inspektimet në lëmin e ndërtimit ishin vetëm 26 kërkesa për leje ndërtimi, për objektet të përkohshme 39 kërkesa, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, në realizimin e të hyrave
- Të rritët bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë të urbanizmit, Gjykatës dhe Policisë, në shtimin e kërkesave nga kërkuesit, mbi dhënien e leje ndërtimit të objekteve , për rritjen e inkasimit, dhe harmonizimin e të hyrave.

Inspektor i ndërtimtarisë - (N.TH)

Inspektori i Ndërtimit sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të parë të vitit 2018, kishte planifikuar 180 Inspektime , Proqesverbalet të Realizuara ishin- 218 Aktvendimet ishin- 10, Fletëparaqitjet ishin -1, Njoftimet-1 Kërkesat- 6, dhe Flet paraqitjet ekzekutuara ishin 4.

Çështja 2 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Nga Inspektimet në lëmin e ndërtimit ishin vetëm 26 kërkesa për leje ndërtimi të cilat janë pranuar dhe zbatuar, në realizimin e të hyrave.
- Të rritët bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë të urbanizmit, Gjykatës dhe Policisë, në shtimin e kërkesave nga kërkuesit, mbi dhënien e leje ndërtimit të objekteve , për rritjen e inkasimit, dhe harmonizimin e të hyrave.

KONKLuzioni

Efektiviteti i kontroleve ka nevojë të përmirësohet në disa fusha të caktuara ku janë identifikuar mangësi. Fushat ku nevojiten më shumë përmirësime janë: Në proqesverbale të realizuara, reduktojnë inspektimet individuale dhe arritjen e objektivave të Komunës.

Inspektori veterinarisë- (F. SH)

Inspektori i veterinarisë sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar 296 inspektime, Proqesverbalet ishin- 319, inspektime ishin 373, njoftimet kërkesat (raport therje) ishin 112, Raporte 150, Raport pune 32.

Çështja 3 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Nga këto inspektime nuk ishte bërë harmonizimi i të hyrave me zyrtarin e të hyrave.
- Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar, Drejtorisë të Shërbimeve Publike, Gjykatës dhe Policisë në rritjen e kërkesave nga kërkuesit për parandalimin e veprimtarive ilegale.

Gjatë ekzaminimit është gjetur një kërkesë të lëshuar nga 6 kompani për therjen e kafshëve, shitjen e mishit dhe produkteve nga mishi. Kërkesa Nr. 64 të dates 11.01.2018. Në bazë të kërkesë është kërkuar nga Drejtoria për punët inspektuese që të dalë dhe

të konstatoj gjendjen faktike, pasi që kanë qenë në dijeni se ekzistojnë disa individë të pa ndërgjegjshëm të cilët mirren me veprimtari ilegale mbi therjen e kafshëve të trasha dhe shitjen e mishit si dhe produktet nga mishi në teritorin e komunës të Rahovecit duke përfshirë edhe fshatrat.

Kërkesa ka qenë e drejtuar organit legjitim në këtë rast drejtorisë për punë inspektuese që të marrin masa urgjente për parandalimin e kësaj dukurie ilegale, po na domtojnë bizneset tona

KONKLUZIONI

Kontrolli i brendshëm tregon se ky sistem nuk është duke funksionuar në nivelin më të lartë në të gjitha segmentet e tij. Duhet theksuar edhe më tutje se problemet për sa i përket inspektimit, të fokusohet për të përmirësuar situatën.

Inspektori sanitar- (M. SH)

Inspektori sanitar sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar 312 inspekte, Proqesverbalet ishin- 301, inspekte ishin 129, Ftesat Kërkesat Konkluzat ishin 33.

Çështja 4 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Nga këto inspekte nuk ishte bërë harmonizimi i të hyrave me zyrtarin e të hyrave.
- Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar, Drejtorisë të Shërbimeve Publike, Gjykatës dhe Policisë në identifikimin dhe eliminimin e dukurive negative.

Inspektori i bujqësisë- (M.E)

Inspektori i Bujqësisë sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar 164 inspekte Proqesverbalet ishin- 204, Aktvendime ishin 2 Ftesat Kërkesat Konkluzat ishin 4.

Çështja 5 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Nga procesverbale individuale nga lëmija e tokës bujqësore ishin 214, të realizuara.
- Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar, dhe Drejtorisë të bujqësisë, në ndalimin e ndërtimeve të egra në tokat bujqësore dhe eliminimin e dukurive negative.
- Për shëndrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore nuk ka mbajtur evidencë apo regjistrimin në raportin mujor dhe vjetor në harmonizimin e të hyrave, me drejtorin e Bujqësisë.

Inspektori i komunikacionit- (M.V)

Inspektori i komunikacionit sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar-243 inspekte, Proqesverbalet të Realizuara ishin- 283, Aktvendimet ishin- 8, Fletëparaqitjet ishin -4, Njoftimet, Kërkesat- 1, Njoftime Kërkesat Konkluzat ishin 2 dhe Flet paraqitjet ekzekutuara ishin 2 për çdo drejtim veç e veç.

Çështja 6 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Nga Inspektimet individuale nga lëmija e komunikacionit, ishin vetëm 12 kërkesa, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, në realizimin e të hyrave.
 - Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë të shërbimeve publike, në rritjen e kërkesave nga kërkuuesit në transportin publik për paisjen me licencim dhe të bëhet evidentimi dhe harmonizimi me drejtorin përkatës që bën inkasimin e të hyrave.
- Inspektori për pylltari dhe mbrojtje të ambientit – (M.I)

Inspektori për pylltari dhe mbrojtje të ambientit sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar -290 inspektime, Proqesverbalet të realizuara ishin- 319, Aktvendimet ishin- 28, Fletëparaqitjet ishin -23, Njoftimet, Kërkesat- 5.

Çështja 7 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Nga Inspektimet në lëmin e mbrojtjes së ambientit, ishin vetëm 24 kërkesa për lejen mjedisore komunale të cilat janë pranuar për realizimin e të hyrave.
- Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë të urbanizmit, Gjykatës dhe Policisë, në shtimin e kërkesave nga kërkuesit, mbi dhënien e leje mjedisore komunale, për rritjen e inkasimit, dhe harmonizimin e të hyrave.

Inspektori i Tregut- (SH.B)

Inspektori i tregut sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar -171 inspektime, Proqesverbale të Realizuara ishin- 244, Aktvendimet ishin- 17, FletëKërkesat, konkluzion- 2, për çdo drejtim veç e veç.

Çështja 8 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Inspektime me procesverbale individuale në kontrollin e regjistrimit të biznesit, obligimi për marrjen e pelqimit të punës, kontrolli i çmimeve, kontrollit i orarit të punës, faturave, librave ishin -215.
- Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, në rritjen e numrit në regjistrimin e bizneseve, marrjen e pelqimit të punës dhe eliminimin e dukurive negative.

Inspektori i Tregut - (SH. SH)

Inspektori i tregut sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar -192 inspektime, Proqesverbale të Realizuara ishin- 215, Aktvendimet ishin- 10, Fletëparaqitje- 1, për çdo drejtim veç e veç.

Çështja 9 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Procesverbale ishin 217 sipas raportit të realizuara,
- Inspektime me procesverbale individuale në kontrollin e regjistrimit të biznesit, obligimi për marrjen e pelqimit të punës, kontrolli i çmimeve, kontrollit i orarit të punës, faturave, librave ishin 215.
- Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, në rritjen e numrit në regjistrimin e bizneseve, marrjen e pelqimit të punës dhe eliminimin e dukurive negative.

Inspektori i Tregut- (V.H)

Inspektori i tregut sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017 dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar -215 inspektime, Proqesverbale të Realizuara ishin- 260, procese pune, 27, Akt pune 27 Aktvendimet ishin- 13, Njoftime kërkesa- 1, Fletparaqitje të ekzekutuara -1.

Çështja 10 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

- Inspektime me procesverbale individuale në kontrollin e regjistrimit të biznesit, obligimi për marrjen e pelqimit të punës, kontrolli i çmimeve, kontrollit i orarit të punës, faturave, librave ishin 260.
- Të rritet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë për Ekonomi dhe

Zhvillim, në rritjen e numrit në regjistrimin e bizneseve, marrjen e pëlqimit të punës dhe eliminimin e dukurive negative.

Inspektori për qeshtje komunal - (S.Q)

Inspektori për qeshtje komunale sipas raportit të gjashtëmujorshit të dytë të vitit 2017

dhe dymujorshit të vitit 2018, kishte Planifikuar -222 inspektime, Proqesverbale të Realizuara ishin- 335, Aktvendimet ishin- 46, Njoftime kërkesa- 5, Fletparaqitje -35, fletparaqitje të ekzekutuara – 42.

Çështja 11 – Inspektimet e realizuara – Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

Nga Inspektimet me procesverbale individuale në kontrollin e hapsirës publike, kërkesat për leje të sipërfaqes publike ishin veëm 26, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, në realizimin e të hyrave

Të shtohet bashkëpunimi në mesë të Drejtorisë të audituar dhe Drejtorisë për shërbime publike , në shtimin e kërkesave nga kërkuessit, mbi dhënien e lejes të sipërfaqes publike , për rritjen e inkasimit, dhe harmonizimin e të hyrave.

KONKLuzioni

Kontrollet e brendshme duhet të rishikohen dhe të përshtaten, ngase siç funksionojnë në formën aktuale, të ofrojnë sigurinë e duhur se objektivat e përcaktuara të Drejtorisë të arrihen.

Çështja 12 - Menaxhimi, kontrolli dhe qeverisja – Prioritet i lartë

Përshkrim

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një proces gjithë përfshirës i të gjitha aktiviteteve të entitetit të audituar i cili zbatohet dhe jetësohet nga Menaxhmenti dhe personeli i tij i angazhuar në të gjitha sistemet dhe nën sistemet.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon nëse menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet.

Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga Drejtoria e audituar të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve

○ Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut në menaxhimi administrativ dhe financiar të sistemit.

Çështja 13 -Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut çështje më prioritet të lartë.

Te gjeturat.

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut, vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në forma të dokumentuar dhe të shkruar , mos ekzistimin e një regjistri të riskut me qëllim të arritjes së objektivave

specifike të përcaktuara.

KONKLUZIONI

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë performancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së performancës së suksesit të Inspektimit

Rekomandimet:

KOMANDIMI – 1

- Rekomandojmë që të forcohet edhe më shumë sistemi i kontrollit të brendshëm, për ti menjauar dobësit në regjistrimin e dokumenteve zyrtare për harmonizimin dhe barazimin e të hyrave.

REKOMANDIMI- 2

- Rekomandojmë Drejtorin e audituar që të rritet bashkëpunimi, në mesë të Drejtorisë për punë inspektuese dhe Drejtorisë të Urbanizmit, planifikimit hapsinor dhe mbrojtje të mjedisit.

REKOMANDIMI- 3

- Rekomandojmë që të forcohet menaxhimi i inspektimit, në kërkesat e kompanive dhe qytetareve, që të zhdukën veprimtarit ilegale.

REKOMANDIMI – 4

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë bashkëpunim më të mirë me Drejtorin e Urbanizmit, Drejtorin e Shërbimeve Publike e tjera për rritjen e inkasimit të të hyrave, të marrë në konsiderat nevojat reale të Drejtorisë.

REKOMANDIMI – 5

- Rekomandojmë që të implementohen të gjitha rekomandimet të dhëna në raportin e punës nga inspektoret.

REKOMANDIMI – 6

- Menaxhmenti i entitetit të audituar me pranimin e përgjegjësisë të deleguara nga Drejtoria e audituar kërkohet të projektoj dhe të hartojnë një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut, vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në formë të dokumentuar dhe të shkruar.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2.1. OBJEKTIVAT:

Objektivat kryesore:

1. Pajtuëshmëria me ligjet dhe legjislacionin në fuqi,
 2. Sistemi i kontrollit të brendshëm i të hyrave dhe shpenzimeve , ekziston dhe funksionon.
 3. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit
 4. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave vetanake
- Zbatimi i Taksës për shërbime inspektuese

2.2. FUSHËVEPRIMI:

Fushëveprimi i auditimit është përqendruar në:

- Grumbullimin e të hyrave vetanake nga Ngarkesat, Kompenzimet dhe taksave në Shërbime për punë inspektuese për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017, dhe dymujorshin e parë të vitit 2018.

Periudha e auditimit 02.03 gjërë me 25.03.2018

Lokacioni; Drejtoria për punë inspektuese

1.4 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë

Të gjeturat:

4, REZULLTATET

4.1. Pajtueshmëria me ligjet dhe legjislacionin në fuqi,

Objektivi kryesor i auditimit

Mbështetur në materialitetin e sistemit të përcaktimit të tarifave nga taksat dhe arkëtimi i të hyra vetanake në planifikimin ton të auditimit kemi parapa të auditojmë sistemin planifikimit të të hyra vetanake, përshtatshmëria e arkëtimeve me tarifat e miratuara, grumbullimin e të hyrave vetjake, objektivat e kontrollit të sistemit të dizajnuara nga Menaxhmenti, vlerësimin dhe identifikimin e rrethave dhe efikasiteti dhe efekteviteti në monitorimin e këtij sistemi.

Objektivi ynë i kontrollit është për të siguruar efikasitetin, dhe efektivitetin e kontrollit në menaxhimin e këtij sistemi për të siguruar dhe formuar një opinion lidhur me funksionimin apo mjaftueshmërinë e tij në menaxhimin dhe kontrollin e këtij sistemi për të ofruar siguri Menaxhmentit të audituar lidhur me funksionimin apo mos funksionimin e kontrollit në këtë drejtim.

4.2. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit

Pasi që procesi i grumbullimit të të hyrave dhe shpenzimeve është shumë i rëndësishëm për buxhetin e Komunes ne kemi planifikuar dhe kryer teste të ndryshme, intervista, vëzhgime.

Drejtorja e Kadastrës, gjeodezisë dhe Pronë, në bazë të Rregullorës nr. 576 të datës 28.02.2017, ngarkohe në realizimin e të hyrave nga Taksat për shërbimet kadastrale, taksat për regjistrim të pronësisë, posedim hipotekave, servituteve, qira mbajtës dhe përquesve.

Këto të hyra përbëhen nga: taksat në regjistrimin e trashëgimisë, taksat administrative për fletëkërkesa dhe taksat për matjën e tokës në teren. Ne kemi kryer testimin e 70% të mostrës në tërë transaksionin në vlerë të ndryshme, të cilat lidheshin me të hyrat taksat në regjistrimin e trashëgimisë, taksat administrative për fletëkërkesa, taksat për matjën e tokës në teren . Kemi bërë vlerësimin dhe rishikimin e procedurave mbi realizimin e të hyrave, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.

Për vitin 2018 kishte planifikuar të hyra në shumën prej 99.000 ,00€, në bazë të raportit të zyrtarit kryesor të të hyrave pranë Drejtorisë për Financa dhe Buxhet shuma totale e inkasimit ishte 29.225,00€, i veqor për secilin drejtim të të hyrave, shuma e inkasuar për taksat në regjistrimin e trashëgimisë ishin në shumën prej 6.451,00€, taksat administrative për fletëkërkes ishin në shumën prej 16.370,00€, taksat për matjën e

tokës në teren ishin në shumën prej 6.404,00€, progresi ishte 29,52%.

Kurse në Drejtorin e audituar sipas raportit të punës të hyrat ishin në shumën prej €. i veqojm për secilin drejtim të të hyrave, shuma e inkasuar për taksa në regjistrimin e trashëgimisë ishin në shumën prej 6.581,00€, taksat administrative për fletkërkes ishin në shumën prej 16.867,00€, taksat për matjën e tokës në teren ishin në shumën prej 6.135,00€. Totali i të hyrave ishte 29.583,00€.

Çështja 1 - Taksat e regjistrimit të shërbimeve kadastrale, regjistrimin e pronës dhe posedimit - Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

4.2.1. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me Zyrtarin e të hyrave të komunës. Çështje në rëndësi

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Të hyrat e realizuara për tremujorshin e parë të vitit 2018 në Drejtorin e audituar nuk janë barazuar dhe harmonizuar me zyrtarin kryesor të të hyrave pranë Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, diferenca e mos barazimit ishte në shumën prej 358,00€.

Fletpagesa komunale të pa procesuara ishin 50 (pesëdhjetë), në një vlerë prej 314,00€.

Fletpagesa komunale të anuluar ishin 10 (dhjetë) në një vlerë prej 78,00€.

Mbledhja e Taksave për shërbimet kadastrale,

Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012 për Tarifën e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale.

Neni 12.2. të Rregullorës për taksa, tarifa, ngarkesave dhe gjobave 01 Nr.576 të datës 28.02.2015.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2018 ishte në shumën prej 20.000,00€, kurse realizimi i të hyrave për tremujorshin e parë ishte në shumën prej 6.404,00€, realizimi kundrejt planifikimit ishte 32,02%.

Sipas raportit të zyrtarit të gjeodezisë pranë Drejtorisë të Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronë, realizimi i të hyrave ishin në shumën prej 6.135,00€, nga këto ishin 144 (njëqind e katërdhjetë e katër) lëndë, (ndarja e parcelave -17, kufizimi i parcelave -2, Bashkimi i parcelave -9, lëndët e gjykatës -22, përshkrimi i kordinatave -57, lëndët zyrtare -2, historiat -3, regjistrimi i parcelës).

Çështja 2 - Taksat e regjistrimit të shërbimeve kadastrale - Prioritet i lartë

TË GJETURAT:

Të hyrat e realizuara për tremujorshin e parë të vitit 2018 në Drejtorin e audituar (shëf i sektorit të gjeodezisë) nuk kishte arritur të kryej barazimin dhe harmonizimin me zyrtarin kryesor të të hyrave pranë Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, diferenca e mos barazimit ishte në shumën prej 269,00€.

Nuk kemi hasur në regjistrimin e të hyrave, shuma totale e të hyrave ishte në raportin e punës.

Të hyrat nuk ishin të ndara sipas lëndëve.

4.3. Taksat administrative për fletkërkesa (Dhënia e dëshmimeve nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesës së palëve).

Neni 12.9. të Rregullorës për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba 01 Nr. 576 të datës 28.02.2017.

Të hyrat e Planifikimi për vitin 2018 ishte në shumën prej 42.000,00€, kurse realizimi i të hyrave për tremujorin e parë ishin në shumën prej 16.370.00€, realizimi ishte 38,98%.

Sipas raportit të referentit për të hyra në Drejtorin e audituar realizimi i të hyrave për tremujorin të vitin

2018 ishin në shumën prej 16.867,00€. Nga kërkesat për çertifikata të pronësisë dhe kopjeve të planit numri i lëndëve ishte 3283.

Çështja 3 - Taksat e regjistrimit administrativ për fletëkërkesa - Prioritet i lartë

Gjeturat:

Të hyrat e realizuara për tremujorshin e parë të vitit 2018 në Drejtorin e audituar (Referenti për fletëkërkesa) nuk kishte arritur të kryej barazimin dhe harmonizimin me zyrtarin kryesor të të hyrave pran Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, diferenca e mos barazimit ishte në shumën prej 497,00€. Nuk kishte regjistër të lëndëve, as protokolim të lëndëve, numri i lëndëve (kërkesat) është nxjerr nga sistemi elektronik.

4.4. Mbledhja e taksave për regjistrimin e pronësisë, posedimit, hipotekave, servituteve, qira mbajtës dhe në bazë të transaksioneve (shitblerës).

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2015 dhe 03/2016 për Tarifatat e shërbimeve dhe regjistrimi i të drejtave të pronës.

Neni 13 të Rregullorës për taksa, tarifa, ngarkesave dhe gjobave 01 Nr.576 të datës 28.02.2017.

Sipas raportit të tremujor të punës vitit 2018, zyrtari për regjistrimin e pronës, kishte evidentuar 236 lëndë, prej tyre ishin: regjistrimi i banesave -8, Hipotek-13, çregjistrimi i hipotekes -10, Shitblerje -100, Trashegimi -43, Falje -4, Ndrim i paluatshëm -1, Mbajtje e përjetshme servitutit -1, Rregjistrim i vijes së kufirit -3, Të ndryshme -53.

Planifikimi për vitin 2018 ishte në shumën prej 37.000,00€, kurse realizimi i të hyrave ishte në shumën prej 6.451,00€, realizimi kundrejt planifikimit ishte 17.44%.

Sipas raportit të punës të zyrtarit për pronë në Drejtorin e audituar realizimi i të hyrave për tremujorin të vitin 2018 ishin në shumën prej 6.581,00€.

Çështja 3 - Taksat e regjistrimit të pronës - Prioritet i lartë

TË GJETURAT:

Të hyrat e realizuara për tremujorshin e parë të vitit 2018 në Drejtorin e audituar (zyrtari për pronë) nuk kishte arritur të kryej barazimin dhe harmonizimin me zyrtarin kryesor të të hyrave pran Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, diferenca e mos barazimit ishte në shumën prej 130,00€.

Nga 236 lëndë, 205 lëndë ishte aprovuar regjistrimi i tyre, ndërsa 31 lëndë ishin të pa aprovuara.

Gjatë zbatimit të pagesave mbi pronë dhe posedimit nuk ishte rrespektuar neni 13, të Rregullorës në fuqi.

Veqojm si më poshtë:

- Kontratën për shitblerje të palueshmërisë të dates 12.01.2018, nr. lëndës 34, vlera e shitblerjes ishte 90.000,00€, vlera e transaksionit ishte 50,00€, kurse pagesa është kryer në vlerë prej 35,00€, sipas faturës nr. serik 1618000031, vlera e pagesës ishte më pak për 15,00€.

Nuk ishte rrespektuar neni 13. 1.4. të Rregullorës në fuqi.

- Kontrata mbi ndarje të dates 09.01.2018 nr. lëndës 20, taksat për regjistrimin e pronësisë, posedimit në bazë të përpjestimit (ndarjes) së pronës ishte 20,00€, nga secili bashkëpronar që bëhet pronarë individual nga pjestimi fizik i pronës, në kontratën mbi ndarje ishin 3(tre) bashkëpronar, pagesa e taksës ishte kryer vetëm 20,00€.
- Kontrata mbi ndarje të dates 15.02.2018 nr. lëndës 127, taksat për regjistrimin e pronësisë, posedimit në bazë të përpjestimit (ndarjes) së pronës ishte 20,00€ nga secili bashkëpronar që bëhet pronarë individual nga pjestimi fizik i pronës, në kontratën mbi ndarje ishin 5 (pesë) bashkëpronar.

pagesa e taksës ishte kryer vetëm 20,00€.

- Kontrata mbi ndarje të dates 16.02.2018 nr. lëndës 129, taksat për regjistrimin e pronësisë, posedimit në bazë të përpjestimit (ndarjes) së pronës ishte 20,00€ nga secili bashkëpronar që bëhet pronarë individual nga pjestimi fizik i pronës, në kontratën mbi ndarje ishin 3 (tre) bashkëpronar, pagesa e taksës ishte kryer vetëm 20,00€.
- Kontrata mbi ndarje të dates 30.01.2018 nr. lëndës 81, dhe taksat për regjistrimin e pronësisë, posedimit në bazë të përpjestimit (ndarjes) së pronës ishte 20,00€ nga secili bashkëpronar që bëhet pronarë individual nga pjestimi fizik i pronës, në kontratën mbi ndarje ishin 5 (pesë) bashkëpronar, pagesa e taksës ishte kryer vetëm 20,00€.
- Kontrata mbi ndarje të dates 06.02.2018 nr. lëndës 98, taksat për regjistrimin e pronësisë, posedimit në bazë të përpjestimit (ndarjes) së pronës ishte 20,00€ nga secili bashkëpronar që bëhet pronarë individual nga pjestimi fizik i pronës, në kontratën mbi ndarje ishin 4 (katër) bashkëpronar, pagesa e taksës ishte kryer vetëm 20,00€.

KONKLuzioni

Drejtoria e audituar ka vendosur kontrolle mbi të hyrat, por kontrollet si të tilla kërkojnë përmirësime të mëtejshme sidomos në sigurimin e një baze të të dhënave të drejta dhe të hyrave të sakta, duke u siguruar se palët sipas kërkesës i kryejnë obligimet e tyre ndaj komunës.

Mungesa e harmonizimeve në lidhje me të hyrat përkatëse mund të rezultojë në shpërdorim të të hyrave dhe do ta zvogëlojë efektivitetin e proceseve të kontrollit të buxhetit.

4.6. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut mbështetur në rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga MFK-ja e obligojnë Entitetin të hartojnë regjistrin e rrezikut i dokumentuar dhe i kompletuar për një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik në menaxhimi administrativ dhe financiar të sistemit.

Çështja 4.6.1. -Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut çështje më - prioritet të lartë.

Te gjeturat

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut, vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në formë të dokumentuar dhe të shkruar, mos ekzistimin e një regjistri të riskut me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara

KONKLuzioni

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë performancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së performancë së suksesit të mësimave

Rekomandimet:

REKOMANDIMI – 1

- Rekomandojm që Drejtoria e audituar të zbatojë barazime dhe harmonizime efektive në baza mujore nëpër të gjitha rrjedhat e të hyrave.

REKOMANDIMI -2

- Rekomandojm që të respektohet Neni 13, dhe Neni 13.1.4. të Rregullorës 01 Nr. 576 të datës 28.02.2017.

REKOMANDIMI -3

- Rekomandojm që menaxhimi të jetë më efektiv në ofrimin e cilësisë së performances në vendosjen e procesit kontrollues në arritjen e objektivave specifike.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

3.1. Fushëveprimi dhe objektivat e këtij auditimi janë:

Fushëveprimi:

Fushëveprimi i auditimit është tremujori i parë të vitit 2018, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Indetifikimin e të hyrave,, aktvendimet, regjistrimet, evidentimet , pagesat dhe barazimet.

Periudha e auditimit: 27.03 gjërë 25.04.2018

Lokacioni: Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.

3.2. Objektivat e këtij auditimi janë:

1. Pajtueshmëria me ligjet dhe legjislacionin në fuqi,
2. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit
3. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave vetanake
4. Mbledhja e Taksave për shërbimet kadastrale,
5. Mbledhja e taksave për regjistrimin e pronësisë dhe posedimit.

1.5 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Kultur, Rini dhe sport

Të gjeturat:

. REZULTATET:

4.1. Sistemi i kontrollit të brendshëm i të hyrave dhe shpenzimeve , ekziston dhe funksionon.

4.1.1. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit

1. Për të siguruar se Entiteti i audituar ka projektuar kontrollin në menaxhimin e procedurave për grumbullimin e të hyrave vetanake të përcaktuar sipas dispozitave.

Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport realizon përkatësisht grumbullon të hyra vetanake në bazë të Nenit 16 të Rregullores komunale për tarifat , ngarkesat dhe gjobat nga shërbimet dhe

veprimtarit komunale nr 576 date 28.02.2018 sipas llojeve të të hyrave të cilat do të i prezantojmë si në vijim:

Taksat për shfrytëzimin e sallave, stadioneve(terreneve sportive), teknikës, biletat dhe anëtarësimi në bibliotekë.

Nr.ren.	EMËRTIMI	VLERA
1	Dhënia në shfrytëzim e sallës së madhe	50,00€
2	Dhënia në shfrytëzim e sallës së vogël	20,00€
3	Shfrytëzimi i sistemit të zërimit jashtë objektit	50,00€
4	Për shfrytëzimin e sallës së madhe për shfaqjet të ndryshme nga biletat e shitura paguen	20% e biletave
5	Biletat për shfaqjen e filmave (salla e madhe)	0,50€
6	Shfrytëzimi i terreneve sportive caktohet nga klubet jashtë Komunës (fusha e hendbollit, futbollit).	50% e biletave
7	Dhënie e skenës mobile për një ditë	300,00€
8	Anëtarësimi në bibliotekë për leximin e librave për një vit	1,00€
9	Subjektet , Organizatat, Shoqatat- për shfrytëzimin e salles në shtepin e cultures – për një tubim	Të liruar
10	Bshkësit fetare, civile, Juridike, dhe të tjera	Të liruar

Çështja 1 – Inkasimi i Taksat për shfrytëzimin e sallave, stadioneve(terreneve sportive), teknikës, biletat dhe anëtarësimi në bibliotekë. - Prioritet i lartë

Bazuar në informacionet e shpalosura dhe mostrat nga evidenca e regjistrimit sipas raportit 12 mujorsh të vitit 2017 dhe raportit tremujorsh të vitit 2018 të hyra nuk kishte nga Dhënia në shfrytëzim e sallës së madhe, Dhënia në shfrytëzim e sallës së vogël, Shfrytëzimi i sistemit të zërimit jashtë objektit, Për shfrytëzimin e sallës së madhe për shfaqjet të ndryshme nga biletat e shitura, Biletat për shfaqjen e filmave (salla e madhe), Shfrytëzimi i terreneve sportive caktohet nga klubet jashtë Komunës (fusha e hendbollit, futbollit), Dhënie e skenës mobile për një ditë.

Kishte të hyra vetëm nga Anëtarësimi në bibliotekë për leximin e librave për një vit(2017), të hyrat ishin 1.032,00€, kurse planifikimi ishte 5.000,00€, Realizimi nuk ishte i knaqshëm 20,64%.

Për tremujorshin e parë të vitit 2018 të hyrat ishin 380,00€, kurse planifikimi ishte 5.000,00€, realizimi ishte 0,076%

Vlera e mostrave është sipas planit vjetor i mjaftueshëm për të krijuar një opinion lidhur me

funksionimin e sistemit dhe përshtatshmërisë.

Çështja 2 - Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake - Çështje më rëndësi

a) Për të siguruar se zyrtari i të hyrave vetanake në baza mujore procedon krahason dhe harmonizon informacionet e të hyrave të entitetit të audituar me zyrtarin komunal të të hyrave.

Përshkrim

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Zyrtari përgjegjës në baza mujore ka harmonizuar dhe barazuar të hyrat vetanake me Zyrtaren e të hyrave për taksat e anëtarësimit në bibliotekë për leximin e librave për një vit.

Nuk ka të gjetura në këtë drejtim që vlen të evidentohen.

4.1.2. Shpenzimet a janë kryer në mënyr të drejtë.

Për të siguruar menaxhmenti i shpenzimeve në baza mujore procedon me shpenzime, krahason dhe harmonizon me zyrtarin komunal të shpenzimeve.

Çështja 3- evidentimi harmonizimi dhe barazimi i dobët i shpenzimeve – prioritet i lartë

Të Gjeturat

Në kontekst të sistemit të shpenzimeve, Drejtoria e audituar nuk kishte vendos kontrollë të mira në menaxhimi e shpenzimeve, si dhe te menaxhimi dhe raportimi i obligimeve të pa paguara.

Auditimi ynë ka vërejtur se menaxhimi i Drejtorisë së audituar nuk mban evidenc as raport mujor dhe vjetor për shpenzime, nuk kanë në evidenc shuma të sakta për krahasim dhe harmonizim të shpenzimeve me zyrtarin komunal të shpenzimeve, janë gjetur vetëm kërkesat dhe disa fatura për shpenzime që mbaheshin në regjistrator.

KONKLUZIONI

Mangësitë në menaxhimin e shpenzimeve dhe mungesa e rregulloreve/udhëzimeve për angazhimin e punëtorëve, në raporte dhe evidenca të shpenzimeve e zvogëlojnë efikasitetin dhe e rrezikojnë arritjen e objektivave të projekteve të caktuara dhe paraqesin shpenzime të parregullta.

4.1.3. Menaxhimi i subvencioneve a është kryer në mënyr të drejtë.

Në kontekst të sistemit të subvencioneve, Drejtoria e audituar nuk kishte vendos kontrollë të mira në menaxhimin e subvencioneve.

Çështja 4 - Aprovimi i subvencioneve për mbajtjen e aktivitetit – Prioritet i mesëm

E gjetura

Për dhënje të subvencionuara , vendimet, marveshjet dhe pagesat për subvencionim Drejtoria e audituar nuk kishte të dhëna, edhe përkundër faktit që aktivitetet veçse ishin zhvilluar, as arsyetimin e shpenzimeve Sipas marrëveshjeve të nënshkruara me rastin e dhënies së subvencioneve për projekte të ndryshme, bartësit e projekteve, obligohen që t'i arsyetojnë shpenzimet e ndodhura, në afat prej 30 ditësh pas realizimit të aktiviteteve të subvencionuara.

Këto raste kanë ndodhur për shkak të bashkëpunimit të dobët në mes të Drejtorisë të audituar, dhe zyrtarit komunal të shpenzimeve.

KONKLUZIONI

Mos posedimi dhe arsyetimi i subvencioneve mund të ndikojë në mosarritjen e objektivave dhe synimeve të Komunës, dhe poashtu rrit rrezikun që fondet të përdoren për qëllime tjera nga ato të planifikuara.

4.1. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut mbështetur në rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga MFK-ja

Çështja 5 -Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut - prioritet të lartë.

Te gjeturat

Drejtorja e audituar nuk ka projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut , vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në forma të dokumentuar dhe të shkruar.

KONKLUZIONI

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të ndikojë në keq menaxhimin e sistemit të vlerës së parasë si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së performances.

Rekomandimet:

REKOMANDIMI – 1

- Rekomandojm që në të ardhmën Drejtoria e audituar të mbaj evidencë të sakta dhe raporte periodike dhe vjetore për shpenzime.

REKOMANDIMI - 2

- Rekomandojm të siguroj që dhënja e subvencioneve të monitorohen dhe regjistrohen nga zyrtarët e Drejtorisë përkatëse në kuadër të Komunës, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore për raportimin dhe arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e subvencioneve.

REKOMANDIMI – 3

- Rekomandojm që Drejtoria e audituar për monitorimin e e sistemeve të formoj një projekt për identifikimin , vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve, të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll, që të arrihet performanca në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te Menaxhmenti i lartë.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

3.1. Fushëveprimi:

Fushëveprimi i auditimit është vitit 2017 dhe tremujori i parë të vitit 2018, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Indetifikimin e të hyrave, regjistrimet, evidentimet , pagesat dhe barazimet.

Periudha e auditimit: 26. 04 gjërë 13.05.2018

Lokacioni: Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport.

1.2. Objektivat e këtij auditimi janë:

2. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit.
3. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave.
4. Inkasimi i Taksave për shfrytëzimin e sallave, stadijumeve(terreneve sportive),teknikës, biletat dhe anëtarësimi në bibliotek.
5. Shpenzimet a janë kryer në mënyr të drejtë.
6. Menaxhimi i subvencioneve a është kryer në mënyr të drejtë.
7. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut

1.6 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Të gjeturat:

4. REZULLTATET

4.1. Menaxhimi, Evidentimi dhe Mirëmbajtja e Pasurisë (Aseteve).

Definicioni i një Pasurie në kuptimin e gjërë është çdo gjë që posedon organizata në sektorin publik që ka

vlerë ekonomike apo këmbimore.

Ekzistojn një numër i kategorive të ndryshme të pasurive që menaxhohen në një organizatë në sektorin publik e këto janë:

- PASURITË KAPITALE
- PASURIT JO KAPITALE
- TË PASURITË KAPITALE - kemi të bëjm me kontrollen e brendshëm dhe me menaxhimin e rrezikut.

Ky grup përfshinë Token, Ndërtesat, Makineritë, Orenditë, Veglat, burimet shpenzuese. Të cilat janë blerë për një afat të vazhdueshëm dhe të gjatë të përdorimit në krijimin e profitit në punë. Ato çregjistrohen kundrejt profitit për jetën e tyre të parapar duke ngarkuar shpenzimet zhvlerësimit (me përjashtim të Tokës).

Objektivat e menaxhmentit për pasuri mund të përfshijnë:

1. Sigurimi dhe menaxhimi efektiv i pasurive të Komunës
2. Kontrollimi i menaxhimit të pasurive
3. Mbajtja e saktë e të dhënave mbi pasuri
4. Ruajtja e pasurive
5. Mirëmbajtja e saktë të dhënave mbi pasurit për çellime të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre.
6. Vendosja e një përputhje në kontabilitetin e Komunës.
7. Vendosja në pasqyrat financiare të pasurive
8. Proces adekuat , efikas dhe transparent I tjetërsimit të pasurive
9. Përputhja me Legjislacionin

Këto objektiva për pasurit na ndihmojnë të identifikojmë rreziqet e zakonshme që ndërlidhen në përdorimin e pasurive në Komunë.

4.1.1. MENAXHIMI I PASURISË

RREGULLOJA MF – NR.02/2013 – PËR MENAXHIMIN E PASURISË JO FINANCIARE NË ORGANIZATAT BUXJETORE

kërkon që të bëhet shpalosja e pasurive jo financiare në shkresat shpjeguese të bashkangjitura në pasqyrat financiare.

Me Vendim të Kryetarit të Komunës, në fillim të vitit 2018 janë formuar komisionet për regjistrim, vlerësim, shpërndarjen e barkodeve dhe asgjësimin e pasurive jo financiare.

Vendimi nr. protokolit 01-01-2018 të datës 03.01.2018 për formimin e komisionit për regjistrimin e pasurive jo – financiare, Vendimi nr. protokolit 01/72/18 të datës 07.02.2018 për formimin e komisionit për vlerësimin e pasurive jo – financiare – nën 1.000,00€.

Vendimi nr. protokolit 01/189/18 të datës 10.04.2018 për formimin e komisionit për shpërndarjen e barkodeve të pasurisë jo – financiare dhe

Vendimi nr. protokolit 01/121/18 të datës 01.03.2018 për formimin e komisioni për vlerësimin dhe asgjësimin e pasurive jo financiare.

Përshkrim

Komuna është e obliguar që të marrin masa të nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurive jo financiare, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Drejtoria e audituar ka procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë sipas kërkesës së rregullore së thesarit 02/2013. Komisionet e formuar për inventarizim me vendim të Kryetarit ka bërë verifikimin, krahasimin, identifikimin që kanë vlerë dhe jashtë përdorimit të pasurisë ekzistuese, dhe vlerësimin për pasuritë e vjetërsuara, të dala nga përdorimi apo tjetërsimin e tyre.

4.1.2. REXHISTRI I PASURIVE JO FINANCIARE

Përshkrim

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se Drejtoria e audituar në fillim të vitit 2018, me anë të komisioneve ka vazhduar procesin e regjistrimit të pasurive, dhe kishte një progres krahasuar me vitin e kaluar, ka arritur të sigurojë një regjistër gjithëpërfshirës dhe të plotë për pasuritë jo financiare, të cilët kanë përfunduar punën duke nxjerr raporte për inventarizim dhe vlerësim të pasurive.

Sipas raportit të komisionit për regjistrim të pasurive jo financiare të datës 01.02.2018 ishin regjistruar të gjitha pasuritë në Komunën e Rahovecit.

Në regjistrin e pasurisë jo financiare nën 1.000,00€ në Administratën Komunale janë evidentuar këto të dhëna 7.291 asete.

Në regjistrin e pasurisë jo financiare nën 1.000,00€ në Objektet shkollore janë evidentuar këto të dhëna 10.792 asete.

Në regjistrin e pasurisë jo financiare nën 1.000,00€ në QKMF "Fahredin Hoti" janë evidentuar këto të dhëna 1.314 asete. Gjithsejt totali i pasurive ishte 29.387.

Me 31.05.2018 komuna ka prezantuar pasuri nën 1.000,00€ neto në vlerë 638.038,34€, që krahasuar me vitin 2017 kishte 742.065,69€. Pra, kemi një rënie neto prej 104.027,35€, rënja ka ndikuar nga komisioni i vlerësimit që është formuar në fillim të vitit 2018, pasuritë ishin vlerësuar me çmime reale, kurse në vitin 2017 nuk ishte formuar komisioni për vlerësim e pasurisë jo financiare, pasuritë nuk ishin të vlerësuara me çmime reale.

Kurse Vlera e pasurisë së regjistruar mbi 1.000,00€ gjërë me datën 31.05.2018 ishte 62.108.722,01€ ndërsa në vitin 2017 ishte 60.556,000€. Pra, kemi një trend pozitiv sa i përket regjistrimit të pasurive komunale. Megjithatë, komuna ende nuk ka arritur të kompletoj regjistrin gjithëpërfshirës të pasurisë komunale.

Çështja 1 – vlerësimi i pasurisë në pajtim me rregulloren - Prioritet i lartë

E gjetura

Ne kemi vërejtur se komisioni për vlerësimin e pasurisë kishte bërë vlerësimin e këtyre pasurive dhe ka përpiluar raportin e vlerësimit deri në datën që ne kemi përfunduar auditimin me 31.05.2018. Neni 24.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare thekson "Pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë kapitale, gjendja e pasurisë kapitale ishte pjesë e pasqyrave vjetore financiare (SIMFK), ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria" në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare".

Megjithatë, komuna ende nuk ka arritur të kompletoj regjistrin gjithëpërfshirës të pasurisë jo kapitale.

Sfidat në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive kanë rezultuar në nënvlerësim material të vlerave të pasurive në shpalosjen e PVF-ve, sidomos për sa i përket tokave.

DEMO-si, ka indentifikuar disa toka të pa vlerësuar, nuk ishte formuar komisioni për vlerësimin e tokave të indentifikuar.

KONKLuzioni

Mungesa e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë rrit rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll të gjitha pasuritë e saj dhe të ketë mangësi në raportim. Mos formimi i Komisionit përkatës ndikon në vlerë jo të sakt në shpalosjen e PVF-ve.

4.1.3. Dokumentimi i lëvizjes së pasurisë (Neni 7),

Të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare (pranimi, shitja, dhurimi, transferimi dhe asgjësimi) duhet të mbështetën në dokumente përkatëse.

Çështja 2 – Lëvizja e pasurive jo financiare- prioritet i lartë

Të Gjeturat

Sipas raportit të komisionit për asgjësim të pasurive jo financiare të datës 31.05.2018 në Komunën e Rahovecit.

Është bërë asgjësimi i trembëdjet (13) aseteve të theksuar në Vendim dhe të evidentuara në raportin e komisionit për zhvlerësim dhe asgjësim. Po ashtu, komuna ka formuar edhe komisionin për identifikimin e pasurive, e cila ka bërë identifikimin e pasurive jo financiare. Sistemi i e-pasurisë është në funksion të plotë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.1.4. PRANIMI I PASURISË JO FINANCIARE

Pranimi i pasurisë jo financiare bëhet nga blerja, ndërtimi, dhurimet dhe transferet nga Organizatat tjera Buxhetore.

Çështja 3 - Pranimi i pasurisë jo financiare (Neni 8) – Prioritet i lartë

E gjetura

Pranimi i pasurisë jo financiare bëhet në Depo në bazë të fletëpranimit përkatës, me nënshkrim nga zyrtari i pranimit, mirpo nuk kishte depo të caktuar për strehimin e të gjitha pasurive të pa përdorura, të gjitha pasurit e pa përdorura mbahen në zyre dhe ne korridore të Komunës. Gjithashtu, sipas standardeve kërkohet të bëhet rivlerësim i pasurive, mirëpo nuk kishte bërë rivlerësim të pasurisë si shkak i mungesës së ekspertëve për këtë lëmi.

KONKLUSIONI

Mungesa e depoz ekzistuese, vështirëson identifikimin e saktë të pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen.

4.1.5. VENDOSJA E BARKODEVE

Përshkrim

Ne kemi vërejtur se komisioni për shpërndarjen e barkodeve kishte bërë vendosjen e barkodeve të gjitha pasurive jo financiare. Është kryer në Administratën komunale, Objektet shkollore, dhe në QKMF. Dhe në të gjitha objektet përcjellëse, ku në total janë shpërndarë 29.387 barkode.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.2. Grumbullimi i të hyrave nga qëraja

4.2.1. Qëraja nga vendosja e Objekteve tregtare

Përshkrimi

Për të siguruar se Entiteti i audituar ka projektuar kontrollin në menaxhimin e procedurave për grumbullimin e të hyrave vetanake të përcaktuar si pas dispozitave që rrjedhin nga UA 11/2011 dhe rregullorja komunale dhe në përshtatshmëri me tarifat e përcaktuara.

Drejtoria e audituar realizon përkatësisht grumbullon të hyra vetanake sipas tarifave të përcaktuara në bazë të Rregullores komunale për tarifat, ngarkesat dhe gjrobat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale nr 576 date 28.02.2017 sipas llojeve të të hyrave të cilat do të i prezantojmë si në vijim:

Gjatë ekzaminimit të të hyrave nga Qëraja gjendja ishte si ne vijim:

- Planifikimi ishte 72.000,00€, kurse
- Totali i të hyrave të inkasuara pesëmujorshiu e parë ishte në shumën 19.790,52€, realizimi ndaj planifikimit ishte 22,82%.
- Në bazë të pasqyrës së borgjeve, ngarkesave dhe pagesave për qëra gjërë me 30.04.2018, janë si në vijim:
- Salldoja e vitit 2017 ishte ----- 35.470,27€.
- Ngarkesat për katëmujorshin e
- Parë të vitit 2018 ishte -----32.937,97€

- Gjithsejt obligimi ishte ----- 68.408,24€
- Të hyrat prej I.IV- 2018 ----- 19.790,52€
- Saldoja në fund të pesëmuorshut të parë të vitit 2018 ishte në shumën prej 48.617,72€,
- Në bazë të raportit për vitin 2018 ekzistojn 31 lokale qe janë në shfrytëzim nga qëramarësit.
- Ishin 29 lokale që i shfrytëzojn Qëramarrësit,

Çështja 4 - Realizim i të hyrave vetjake– Prioritet i lartë.

E gjetura

Gjatë auditimit është vërejtur se Drejtoria e audituar në përgjithësi kishte vendosur kontrolle mbi të hyrat si në procesin e regjistrimit ashtu edhe atë të raportimit megjithatë, ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme, sidomos në nxjerrjen dhe aplikimin e politikave dhe mekanizmave adekuate në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga qiratë dhe borxhet tjera si dhe sistemet e faturimit. Përveç kësaj, ekziston një nevojë për përmirësim në disa procese për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së të hyrave. Është vërejtur se nga gjithsej shuma e obliguesve prej 68.408,24€ për pronat e dhëna me qira, gjatë pesëmuorshut të parë të vitit 2018 kishte inkasuar vetëm 19.790,52€ apo 28,93% e qirave. Ne kemi testuar 9 mostra të dhënies me qira të pronës komunale në vlerë 32.234,10€, dhe kemi vërejtur se këta shfrytëzues nuk kishin paguar fare obligimet e tyre. Drejtoria e audituar vazhdimisht kishte bërë presion dhe vërtetë me shkrim, kurse masa tjera nuk është marr, për t'i obliguar shfrytëzuesit që t'i kryejnë obligimet e tyre. Shuma totale e debitorëve ndaj komunës për qiratë e pa paguara në fund të muajit maj të vitit 2018 ishte 48.617,72€.

KONKLuzioni

Mos mbledhja e të hyrave nga objektet e dhëna me qira ndikon që projektet kapitale të planifikuara të financohen nga hyrat vetjake, të mos realizohen. Kjo reflekton politikat e dobëta të arkëtimit, të cilat rrezikojnë maksimizimin e të hyrave dhe arritjen e objektivave të përcaktuara të komunës.

4.2.1.1. Harmonizimi i të hyrave vetanake në raport me Zyrtarin e të hyrave vetanake

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në baza ditore dhe mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale

Përshkrim i shkurtër për këtë sistem

- Zyrtari përgjegjës i angazhuar në këtë proces në mënyrë mjaftë profesionale dhe në baza mujore ka harmonizuar informacionet e realizuar të të hyrave vetanake me Zyrtaren e të hyrave komunale në mënyrë të dokumentuara dhe në formë të shkruar.

4.3. Të gjitha Kontratat të janë të lidhura

- Në bazë të raportit për vitin 2018 ekzistojn 31 lokale qe janë në shfrytëzim nga qëramarësit.
- Ishin 29 lokale që i shfrytëzojn Qëramarrësit,

Çështja 5 – Lidhja e Kontratave - Prioritet i mesëm

E gjetura

Drejtoria e audituar i ka vazhduar kontratat e qiramarrësve të objekteve të Komunës të cilët kanë borxhe të papaguara nga vitet paraprake ndaj Komunës, por të njëjtit qiramarrës vazhdojnë aktivitetin e tyre në objekte të Komunës. Komuna vazhdon të bëjë kërkesë për arkëtimin e qirasë duke u bazuar në kontratë për vitet 2018

KONKLuzioni

Ky fakt shpalos dobësi serioze në zbatimin e kontrolleve të komunës për pronat e dhëna me qira. Dobësitë e identifikuar në menaxhimin e kontratave të koncesioneve dhe qiradhënieve rezultojnë me humbje financiare për komunën dhe reduktojnë aftësinë e komunës për financimin e projekteve nga burimet vetjake.

4.4. Grumbullimi i të hyrave nga taksat Komunale të Biznesit

Objektivat e Auditimit

Të sigurohemi se:

- 4.4.1. Përpilimi i Aktvendimeve me kohë, ngarkesat përputhën me tarifat Komunale dhe shpërndahen me kohë.
- 4.4.2. Grumbullimi dhe regjistrimi i pagesave të taksave të biznesit në bazë të procedurës
- 4.4.1. Përpilimi i Aktvendimet me kohë, ngarkesat përputhën me tarifat Komunale dhe shpërndahen me kohë.

Në librin e dosjeve të Subjekteve afariste për vitin 2018 janë të regjistruara 1945 Subjekte afariste.

- 491- Aktvendime janë lëshuar të cilat janë regjistruar në një regjistër të veçant bashkë me të dhënat të cilat i ka poseduar për ato biznese,
- 472 - Subjekte afariste ishin të ngarkuar me taksë afariste për vitin 2018
- 851- Subjekte afariste ishin të liruar nga ngarkesat e taksës afariste për vitin 2018
- 622 – Subjekte afariste ishin në pasiv ose nuk punojn në vitin 2018
- 05- S.A. qe kanë deklaruar që nuk punojn për vitin 2018
- 8- S.A. që kanë refuzuar Aktvendimin për vitin 2018
- 07 – S.A. ishin pasiv

Aktvendimet janë shtypur me kohë.

Aktvendimet janë në pajtueshmeri me tarifat të cilat janë harmonizuar në bazë të Rregullorës të Komunës.

Të gjitha Aktvendimet janë me të dhëna complete si kërkohen në vet formën standard të Aktvendimit

Të dhënat e çdo Afaristi në biznes janë të vendosura në dosje.

Me rastin e shpërndarjes së Aktvendimeve Drejtoria aplikon një form standard të fletë kthesave për shpërndarjen e Aktvendimeve. Këto fletë kthesa shërbejnë si dëshmi për pranim dorëzimit të Aktvendimit nga Subjektet afariste, këto fletë kthesa i bashkangjiten kopjes së Aktvendimit dhe është vendosur në dosje.

Gjatë ekzaminimit të Aktvendimeve dhe dokumenteve të tjera, gjetjet tona konstatojnë se:

- Vetëm 296 firma janë verifikuar gjatë vitit 2018
- 31 subjekte afariste të reja janë regjistruar dhe janë ngarkuar për vitin 2018
- Zyrtari i taksave afariste nuk ka dëshmi për Subjekte afariste që janë pasive apo që nuk punojnë.
- Subjektet afariste që e kanë refuzuar Aktvendimin nuk është marrë ndonjë masë ligjore.
- Ankesa nuk kishte nga subjektet afariste.

Çështja 6 – Moszbatimi i E-programit dhe taksat për ushtrimin e veprimtarive të biznesit – Prioritet i lartë

E gjetura

Evidenca për 1945 biznese mbahet në programin aplikativ Excel, por ky program aplikativ nuk jep shumë informata analitike për secilin biznes. Për sa i përket bizneseve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre, komuna disponon listën në një program në Excel, por nuk ka siguri se lista mund të jetë e plotë në mungesë të komisioneve për identifikimin e bizneseve të reja dhe atyre që janë shuar e që vazhdon t'i mbajë në regjistrë.

Drejtoria e audituar nuk e bën faturimin e rregullt mujor për secilin obligues dhe se fatura lëshohet në momentin e kërkesës për pagesë nga biznesi.

KONKLUSIONI

Mos funksionalizimi i plotë i programit dhe baza jo e plotë e të dhënave me ushtruesit e veprimtarisë së bizneseve, mungesa e komisioneve përkatëse për identifikimin e bizneseve të shuara apo të regjistruara rishtazi mund të rezultojë me dështime të evidentimit të firmave.

4.4.2. Grumbullimi dhe regjistrimi i pagesave të taksave të biznesit në bazë të procedurës

Pagesat e taksave të biznesit grumbullohen dhe regjistrohen si duhet.

Gjatë rishikimit të procesit të grumbullimit dhe pagesave kemi konstatuar se të gjitha pagesat bëhen me faturë në llogari bankare.

100% të faturave janë ekzaminuar.

Të dhënat lidhur me pagesat e këtyre (ekstraktëve bankare) regjistrohen në regjistrin kontabël nga zyrtari i taksave afariste dhe në sistemin e bankës nga zyrtari për të hyra.

Çështja 7 – Të hyrat nga taksa komunale për biznese – Prioritet i mesëm

E gjetura

Të hyrat e planifikuara për vitin 2018 ishin në shumën prej 80.000,00€. Drejtoria e audituar kishte ngarkuar bizneset me taksa për ushtrimin e veprimtarive në vlerë prej 101.737,00€, për vitin 2018, ndërsa për katërmujorshin e parë të vitit aktual, kishte inkasuar 34.854,00€ apo 34,26%,

Ngarkesa për kryerjen e pagesës është bërë me anë të faturave, ishin 99 fatura të lëshuara për pages në shumën prej 35.624,00€.

Gjatë ekzaminimit të faturave, dy fatura të lëshuara për pagesën e taksës nuk ishin të inkasuara, fatura Nr.1618000011 të datës 30.01.2018 në shumën prej 500,00€, dhe fatura Nr. 1618000012 të datës 30.01.2018 në shumën prej 500,00 nga subjekti afarist (Ndërmarrja) KS "Kosova e re" SH.A.

Ngarkesa e bizneseve ishte më e lartë se planifikimi, Konstatohet se planifikimi nuk është caktuar në bazë të ngarkesës.

Nuk ishte funksional plotësisht programi për qëllim regjistrimin e të dhënave nga taksat në biznes, për faktin se nuk barten llogaritë e arkëtueshme prej viti në vit në mënyrë elektronike, por manualisht. Sipas zyrtarit të taksave biznesore, llogaritë e arkëtueshme në total ishin 943.713,00€.

Sipas rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba është e caktuar tarifa se me çfarë shume vjetore do të ngarkohet secili biznes nga komuna. Gjatë rishikimit të evidencës së taksës në firmë, nuk kemi vërejtur se ka ndonjë mekanizëm për të inkasuar borxhet e akumuluar. Shuma totale e trashëguar nga vitet paraprake ishte 841.976,00€. Po ashtu, janë dhënë vendime për ushtrimin e veprimtarisë afariste pa i kryer obligimet paraprake

Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake në raport me Zyrtarin e të hyrave vetanake të komunës.

Çështje më rëndësi

a)Për të siguruar se zyrtari i të hyrave vetanake në baza mujore procedon krahason dhe harmonizon informacionet e të hyrave të entitetit të audituar me zyrtarin komunal të të hyrave.

Përshkrim

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar në përditësore dhe sistematike, në baza mujore në formë të shkruara i ka krahasuar dhe harmonizuar informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

KONKLUZIONI

Mos funksionalizimi i plotë i programit mund të rezultojë me dështime në planifikimin real të taksave dhe mbledhjen e tyre në shkallë të kënaqshme. Si rrjedhim, plani i të hyrave mund të mos përmbushet.

Mungesa e një strategjie për të inkasuar shumat e akumuluar nga viti në vit mund të rrezikoj që këto të hyra të shndërrohen në borxhe të këqia dhe të bëhen të pa mbledhshme.

Zbatimi i sistemit manual për grumbullimin e informatave në lidhje me të hyrat nga taksa, mund t'i nënshtrohet manipulimit me të dhëna apo gabimeve. Po ashtu, dhënia e vendimeve për ushtrimin e veprimtarisë afariste pa i kryer obligimet paraprake, rrit rrezikun për mos inkasimin e të hyrave sipas

planit.

Rekomandimet:

REKOMANDIMI - 1

- Rekomandojm që Drejtoria e audituar duhet të sigurohet që të kryhet identifikimi dhe vlerësimi i pasurisë së komunës dhe të ketë regjistra të plotë të pasurisë. Komisioni i vlerësimit të formohet, të bëjnë vlerësimin e tokave të indentifikuara, të krahasoj gjendjen kontabël me gjendjen faktike dhe të verifikoj ekzistencën fizike të pasurive.

REKOMANDIMI - 2

- Rekomandojm që Drejtoria e audituar të siguroj një depo për strehimin e pasurive të pa përdorura.

REKOMANDIMI -3

- Drejtoria e audituar duhet të zbatojë rishikim sistematik për të përcaktuar barrierat për rritjen e shkallës aktuale të inkasimit të të hyrave dhe për zvogëlimin e shkallës së borxheve historike, si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të situatës.

REKOMANDIMI - 4

Drejtoria e audituar duhet të vendosen masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike.

REKOMANDIMI -5

- Drejtoria e audituar duhet të kërkojë që programi (softueri) të vihet në funksion me qëllim që mbajtja e të dhënave të ofroj informata të mjaftueshme për secilin biznes.

REKOMANDIMI - 6

- Rekomandojm që të kërkojnë veprime konkrete nga organet kompetente për ndalimin e atyre bizneseve të cilët nuk i janë përgjigjur obligimeve.
- Rekomandojm që Drejtoria e audituar të aplikoj masa efektive që taksat e biznesit të inkasohen sipas periudhave të vitit, duke mos injoruar edhe borxhat e mëhershme.
- Rekomandojm vendosjen e një programi elektronik që të barten llogaritë e arkëtueshme prej viti në vit në mënyrë elektronike.

Përshkrim i shkurtër i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

1.1. Fushëveprimi:

Fushveprimi i auditimit është Pesëmuji i parë të vitit 2018, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Identifikimin e të hyrave, regjistrimet, evidentimet , pagesat dhe barazimet.

Periudha e auditimit 20.05 gjërë 15.06.2018

Lokacioni: Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

3.2. Objektivat:

1. Menaxhimi, Evidentimi dhe Mirëmbajtja e Pasurisë (Aseteve).
2. Realizimi dhe harmonizimi i të hyrave nga qëraja.
3. Ngarkesat vjetore për veprimtari afariste të bizneseve. (sipas librit të ARBK-së)
4. Dhënia në shfrytëzim të pronës komunale (ankand publik) Taks mujore.

1.7 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i brendshëm në Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale (QKMF)

Të gjeturat (përshekruaj të gjeturat)

. REZULLTATET:

Objektivi kryesor i auditimit

Mbështetur në materialitetin e sistemit të përcaktimit të tarifave nga participimi dhe arkëtimi i të hyrave vetanake, planifikimin ton të auditimit kemi parap të auditojmë sistemin planifikimit të të hyrave vetanake, përshtatshmëritë arkëtimeve me tarifat e miratuara dhe grumbullimi i të hyrave vetjake, dhe objektivat e kontrollit të sistemit dizajnuara nga Menaxhmenti, vlerësimin dhe identifikimin e rrezikut dhe efikasiteti dhe efektiviteti në monitorimin e këtij sistemi.

Objektivi ynë i kontrollit është për të siguruar efikasitetin, dhe efektivitetin e kontrollit në menaxhimin e këtij sistemi për të siguruar dhe formuar një opinion lidhur me funksionimin apo mjaftueshmërinë e tij në menaxhimin e kontrollin e këtij sistemi për të i ofruar siguri Menaxhmentit të audituar lidhur me funksionimin apo mjaftueshmërinë e kontrollit në këtë drejtim.

4.1. TË GJETURAT:

4.1.2. Inkasimi dhe realizimi i të hyrave

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale realizon përkatësisht grumbullon të hyra vetanake në buxhetin Rregullores komunale për tarifat , ngarkesat dhe gjobat komunale nr. 576 date 28.02.2017 sipas llojeve të të hyrave të cilat do të i prezantojmë si në vijim:

- Taksat për shërbimet shëndetësore në nivel parësor,
- Taksat për shërbimet stomatologjike në nivelin parësor dhe

- **Tarifat për sektorin e QPS-së**

QKMF-ja realizon të hyra nga participimi, Certifikatat tjera dhe nga taksat administrative për fletëkërkesa, në kemi kryer testimin e një mostre e tërë transaksionesh në vlera të ndryshme, të cilat lidheshin më të hyrat nga participimet dhe Certifikatat tjera. Kemi bërë vlerësimin dhe rishikimin e procedurave mbi realizimin e participimit, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së participimit nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.

Për të siguruar se Entiteti i audituar ka projektuar kontrollin në menaxhimin e procedurave për grumbullimin e të hyrave vetanake të përcaktuar sipas dispozitave.

Bazuar në informacionet e shpalosura dhe mostrat nga evidenca dhe raporti gjashtëmujorshit të parë të vitit 2018 nga zyrtari kryesor pranë Drejtorisë për Financa dhe Buxhet inkasimi i të hyrave ishin 16.388,50€, kurse planifikimi ishte 50.000,00€, Realizimi ishte (32,78%).

Çështja 1 – Menaxhimi i procesit të inkasimit dhe regjistrimit të të hyrave – Prioritet i lartë

E gjetura

Regjistrimi i të dhënave për të hyrat e inkasuara nga participimet bëhet në mënyrë manuale. Kjo për shkak se QKMF-ja nuk posedojnë ndonjë softuer për menaxhimin e tyre. Të dhënat manuale ekzistuese menaxhohen në mënyrë të dobët, nuk janë mbajtur regjistra të brendshëm në lidhje me të hyrat e mbledhura, për qëllime të raportimit janë shfrytëzuar të dhënat në arkë.

QKMF-ja nuk posedon softuer për regjistrimin, klasifikimin dhe raportimin e të hyrave, ende nuk është funksionalizuar moduli për të hyra në Sistemin e Informimit Shëndetësor (SISh), përmes të cilit do të evidentohet realizimi dhe raportimi i të hyrave.

Sipas raportit të gjashtëmujorshit të parë të vitit 2018, vizitat mjeksore ishin 48179 pacient, kanë participuar 9766 pacient, të liruar nga participimi ishin 38413 pacient.

Përqindja e participimit ishte e ultë (20,27%).

KONKLuzioni

Procesimi aktual i informatave për të hyrat duke mos e përdorur modulin e të hyrave në SISh, mund të sjell deri tek gabimet dhe marrjen e vendimeve në mungesë të informatave të sakta.

4.1.3. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake - Çështje më rëndësi

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Me pas në mënyrë të detajuar i paraqesim si më pas procedurat e krahasimeve dhe harmonizimeve.

Përshkrim

Zyrtari financiar Brenda Drejtorisë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Barazimet dhe harmonizimet për të hyrat e regjistruara janë bërë në baza mujore me zyrtarin e të hyrave komunale dhe me arkën e QKMF-së në mënyrë të dokumentuara dhe në formë të shkruar, të cilët pastaj kryen barazimet e rregullta me Thesarin.

QKMF-ja për periudhën audituese ka grumbulluar të hyra në vlerë prej 16.480,50€, kurse sipas raportit të gjashtëmujorshit të parë të mirëmbajtur nga zyrtari komunal i të hyrave vetjake janë realizuar të hyra në vlerë prej 16.388,50€.

Diferenca e mos barazimit ishte 92,00€. Diferenca është, sepse në raportin bankar janë regjistruar pas datës 30.06.2018. Kurse në raportin e zyrtarit financiar në Drejtorisë të audituar, ishte si e hyrë në periudhën përkatëse.

4.1.4. Indetifikimi dhe regjistrimi në librin e protokollit.

Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit ne indentifikuam se regjistrimi i pacienteve në librin e protokollit nuk ishte kryer, duke i krahasuar të hyrat nga participimi, konstatohet se indentifikimi nuk ka qenë i rregullt, gjë që ka rezultuar në inkasimin minimal të të hyrave.

QKMF-ja gjeneron të hyra nga pagesat për kujdes shëndetësor (participimet) dhe certifikatat tjera.

Përshkrimi i shkurtër

Auditimi është bërë në të gjitha njësit punuese.

QKMF-ja në këto njësi si më lartë kishte dizajnuar sistemin e kontroleve të brendshme që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave nga participimi, dhe regjistrimin e faturave menaxhimi i kësaj fushe kërkohet që të përmirsohet, duke mos krijuar harmonizime dhe krahasime të rregullta mujore ndërmjet librit të protokollit dhe participimit.

Çështja 2 - Dobësi e kontrollit në regjistrimin e participimit në librin e protokollit dhe faturave - Prioritet i mesëm.

-Ne kemi vërejtur se kontrolli i brendshëm ka treguar dobësi në harmonizimin dhe krahasimin e participimit në librin e protokollit dhe harmonizimin e faturave me depon, me gjendjen që përfundon më 30.06.2018.

KONKLuzioni

Ne konkludojmë se kontrolli i brendshëm në QKMF-në për sa i përket mbikëqyerjes së procesit të krahasimit dhe harmonizimit e librit të protokollit me participimin mund të jetë më funksional.

4.1.5. Magazinimi dhe shpërndarja e barnave esenciale

Barnat esenciale për nevojat e QKMF-së të furnizuara nga Korporata farmaceutike e Kosovës të blera nga Ministria e Shëndetësisë për nevojat e QKMF-së në Komunë.

Përshkrimi i shkurtër

Furnizimi nga Ministria e Shëndetësisë:

Zyrtari i angazhuar në pranimin e barnave esenciale sipas një regjistri të barnave për periudhën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2018 të furnizuara nga Ministria e Shëndetësisë janë pranuar 12 fatura në shumën prej 49.018,74€, kurse salldoja e stoqeve nga viti 2017 ishte në shumën prej 5.673,35€, totali i barnave esenciale ishte në shumën prej 54.692,09€.

Nga depoja ishin shpërndarë 257 fatura në njesitë punuese në shumën prej 46.013,47€,

Furnizimi nga Komuna:

Depoisti i barnave ampulara dhe tabletare, sipas një regjistri të barnave për periudhën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2018 nuk kishte furnizime nga Komuna, me procedurë të prokurimit.

Salldoja e stoqeve nga viti 2017 ishte në shumën prej 6.976,30€.

Nga depoja ishin shpërndarë 57 fatura në shumën prej 4.373,95€,

Me daljen në teren gjatë auditimit është bërë rishikimi i të gjitha faturave në njesitë punuese, faturat e pranuar mbaheshin në regjistrat, nuk ishin evidentuar në formë të shkruar.

Konstatohet se shpërndarja është bërë sipas kërkesës në mënyrë të rregullt,

Çështja 3 - Mos regjistrim i barnave të furnizuara në Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF)

E gjetura

Moduli i Sistemit të Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF) është njëri nga komponentat e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH). Në të duhet të regjistrohen të gjitha transaksionet (hyrjet, daljet dhe sasia në stok) e barnave të Listës Esenciale.

Ne kemi vërejtur se barnat e blera për Listën Esenciale (LE) në vlerë 54.692,09€, nuk ishin rexhistruar në softuerin SMSF, përderisa evidentimi i hyrje -dalje është bërë manualisht.

Kjo mund të ndikoj që informatat në lidhje me gjendjen e stokut përfundimtar të barnave për gjashtëmuorshin e parë të vitit 2018 të mos jenë të sakta dhe të besueshme.

Informacionet në SMSF nuk ofrojnë siguri për arsye se gjendja reale mund të dallon nga të dhënat në system. Nga depoja ishin shpërndar 257 fatura të barnave esenciale, të furnizuara nga Ministria e Shëndetësisë, gjatë rishikimit të faturave në teren nëpër njësi punuese kemi indentifikuar vetëm 214 fatura, të pa indentifikuar janë edhe 43 fatura.

Nga depoja ishin shpërndar 57 fatura të barnave ampullare dhe tabletare, të furnizuara nga Komuna me procedur paraprak të prokurimit, gjatë rishikimit të faturave në teren nëpër njësi punuese nuk kemi indentifikuar as një faturë.

4.1.6. BARNATORJA QENDRORE

Barnatorja qendrore ishte furnizuar me barna esenciale nga depoja për nevojat e pacienteve.

Nga data 02.01 gjërë 20.06.2018, ishte furnizuar me barna, me anë të 6 (gjashtë) faturave të dhëna në cop, çmim dhe shumë.

Çështja 4 Shpërndarja e barnave nga barnatorja – prioritet i lartë

E Gjetura

Gjatë rishikimit të faturave ishin të gjitha të marra në cop, çmim dhe shumë në një vlerë prej 24.216,51€.

Kemi marr si mostër barin (insulinën) më të kërkuar nga pacientet.

Ishin listat e pacenteve të varur nga isulina për çdo muaj të nënshkruara, sipas sasisë në bazë të recetit të dhënë nga Mjeku.

Numri pacenteve prej muajit janar gjërë në muajin qërshor variron në listë, në muajin qërshor ishin 313 pacient të evidentuar, në çdo muaj kishte pacient qe nuk kan nënshkruar në listë, në muajin qërshor ishin 61 pacient nuk e kan marr barin, vërtetohet në mos nënshkrimin e pacienteve, barnat e mbetura janë bartur si stok në muajt në vijim, të tjerët që kanë nënshkruar në listë, ishin furnizuar me anë të recetit të dhënë nga Mjeku të cilet mbahën si dëshmi në regjistrat.

Gjatë auditimit nuk kemi mundur të vlerësojmë identifikimin e të gjitha receteve, sepse nuk janë të ndara sipas faturës, që mund të ndikoj që të dhënat për stoqe të mos jenë të sakta dhe të besueshme.

Barnatorja qendrore nuk posedon softuer për regjistrimin e faturave, ende nuk është funksionalizuar moduli për regjistrimin e në Sistemin e Informimit Shëndetësor (SISH), përmes të cilit do të evidentoheshin barnat në cop, çmim dhe shumë, përderisa evidentimi i hyrjeve - daljeve është bërë manualisht.

KONKLuzioni

Mos regjistrimi i furnizimit së barnave në SMSF, rrit rrezikun që Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të bëjë furnizime përderisa ka sasi të mjaftueshme në stok ose e kundërta të shkaktohen vonesa në furnizim me barna kur nevojiten ato.

Regjistrimet manuale mund të jenë jo të plota dhe mund të sjellin veshtirësi në menaxhimin e

barnave esenciale dhe të stokut, duke shkaktuar shpeshherë mungesa të barnave nga lista esenciale dhe sasi të tepërta për artikuj të tjerë.

4.1.7. Pranim dorzimi i Blllok dëftesave

Procedurat e pranim dorëzimit të blllok dëftesat ,arkëtimi dhe depozitimi në llogarinë zyrtare.

Për të rishikuar se entiteti i audituar ka vendosur kontrole adekuate në menaxhimin e sistemit të pranim të blllok dëftesave nga furnitori, me kohë nga ana e zyrtareve të autorizuar për inkasimin e participimit në QKMF.

Përshkrimi i shkurtër

Bazuar ne informacionet e shpalosura e mësipërme të mostrave substanciale qe i kemi marr për testim gjatë një testimi te detajuar kemi hasur dhe konstatuar disa te gjetura të cilat do të i prezantojmë si më pas:

Çështja 5 - Regjistrimin i stokut të blllok dëftesave për arkëtim me gjendjen që përfundon më 30.06.2018 - Prioritet i mesëm

Të Gjeturat

Zyrtari i angazhuar në sistemin e pranim dorëzimit të blllok dëftesave për arkëtimin e të hyrave vetjake në QKMF-në, ishin të bartura (pakuara) 406 blllok dëftesa me 02.01.2018, Stoku i bartjes është bërë nga vetë zyrtari për pranim dorëzimin e blllok dëftesave.

Gjatë auditimit në listen e regjistrimit të blllok dëftesat në form raporti ditor kishte të dhëna të punëtoreve qe kanë blllok dëftesa të pa përfunduar, sasija e tyre ishte 45 që nuk janë dorëzuar në zyrën e pranim, dhe nuk është kryer inkasimi në arkë.dhe

Ishin 15 blllok dëftesa të shpenzuara nga vitet paraprake që nuk janë dorëzuar në zyrën e pranim – drëzimit të blllokave, dhe nuk është kryer inkasimi në arkë.

Ne kemi vërejtur se kontrolli i brendshëm ka bërë evidentimin e stokut të blllok dëftesave si dëshmi për inkasimin e pagesave për participimin për QKMF-në me gjendjen si informacion i sasisë së bartur në vitin 2018.

Evidentimi i hyrje -dalje është bërë manualisht. ende nuk është funksionalizuar moduli për regjistrimin në Sistemin e Informimit Shëndetësor (SISh).

KONLUZIONI

Mos regjistrimi në sistemin e informimit shëndetësor (SISh) rrit rizikun e besueshmërisë të saktësisë së stokut të pranuar të cilat do të shfrytëzohen në vitin në vijim.

4.1.8. Tarifat për sektorin e QPS-së

Spektori i QPS-së realizon përkatësisht grumbullon të hyra vetanake në bazë të Rregullores komunale për tarifat , ngarkesat dhe gjobat komunale nr. 576 date 28.02.2017 sipas llojeve të të hyrave të cilat do të i prezantojmë si në vijim:

- Vërtetim për lirim nga shtetësia e Kosovës dhe*
- Vërtetim që nuk është hequr zotësia e punës dhe e veprimt.*

Për të siguruar se Entiteti i audituar ka projektuar kontrollin në menaxhimin e procedurave për grumbullimin e të hyrave vetanake të përcaktuar sipas dispozitave.

Bazuar në informacionet e shpalosura dhe mostrat nga evidenca dhe raporti gjashtëmujorshit të parë të vitit 2018 nga zyrtari që krijon të hyra, inkasimi ishin 632,00€, kurse të planifikuara nuk kishte.

Çështja 6 – Menaxhimi i procesit të inkasimit dhe regjistrimit të të hyrave – Prioritet i lartë

E Gjetura

Regjistrimi i të dhënave për të hyrat e inkasuara nga tarifat e cekura më lartë nuk bëhet as në mënyrë manuale, as në mënyrë elektronike (SISH).

Nuk janë mbajtur regjistra të brendshëm në lidhje me të hyrat e mbledhura, për qëllime të raportimit.

Nuk janë shfrytëzuar dëftesat e fletpagesave në bazë të numrit serik.

4.1.9. Mirëmbajtja e dosjeve të punëtorëve në zyrën e personelit.

Çdo dosje të nëpunsit duhet ti ketë të dhënat përfshirë kopjen e dokumenteve që vërtetojnë moshën e nëpunsit civil, përgaditjen profesionale e arsimore, vendbanimin një kopje e kontratës së punësimit dhe dokumentët tjera, kërkesën e punës dhe materialet plotësuese, detyrat e punës, pushimin dhe vijimin e punës, vlersimet, pagat, aftësimin dhe hollësit e çfarëdo mase diciplinore, të dhënat e vijimit të kursëve të aftësimi dhe të arriturat.

Çështja 7 - Mangësit në dosje të punëtorit – prioritet i lartë

E Gjetura

QKMF-ja nuk ka arritur të vendosur kontrolle adekuate sa i përket menaxhimit në mirëmbajtjen e dosjes së punëtorëve.

Gjatë ekzaminimit është gjetur në katërmëdhjet (14) dosje të punëtorëve ju është skanduar kontrata e punës, gjë që në përfundim të auditimit Ne nuk kemi arritur të marrim siguri lidhur me kontratat e lëshuara.

KONKLuzioni

Janë vërejtur veprime të dukshme të kontrollit e cila është çështje e menaxhmentit për përmirësime të rëndësishme, që është kërkuar veprime të menjëhershme përmirësuese për tu mbrojtur në mënyrë adekuate kundrejt ekspozimit.

4.1.10. MENAXHIMI I REZIKUT

Çështja 8 – Menaxhimi i rrezikut – prioritet i lartë.

E gjetura

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nuk kishte hartuar regjistrin e rreziqeve. Për këtë arsye ne nuk kemi mundur të vlerësojmë identifikimin e të gjitha rreziqeve që mund të kenë ndikim tek Drejtoria në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Megjithatë, në gjashtëmujorshin e dytë Drejtoria e audituar do të ndërmarrë masa duke hartuar raportin e rreziqeve për menaxhimin e tyre, që pritet që të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. i cili do të vlerësohet në auditimin e viteve të ardhëshme.

KONKLuzioni

Mos përgatitja e regjistrit të rreziqeve ndikon që menaxhmenti të mos identifikojë dhe të menaxhojë rreziqet të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të Drejtorisë.

Rekomandimet (përkrahja e rekomandimeve, të cilat kanë të bëjnë me të gjeturat e përshkruara)

REKOMANDIMI – 1

- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duhet të sigurojë që në kuadër të SISH-it të funksionalizohet moduli i të hyrave. Veç kësaj Drejtoria e QKMF-së duhet të zbatojë*

mekanizma të kontrollit që mundësojnë koordinimin e informatave në mes të njësive që krijojnë të hyra dhe drejtorisë të financave për të pasur informata të sakta në lidhje me të hyrat dhe llogaritë e arkëtueshme.

REKOMANDIMI – 2

- *Rekomandojmë njësit punuese që bëjnë evidentimin e pacienteve në librin e protokolit të bëjnë harmonizimin e participimit në librin e protokolit dhe harmonizimin e faturave me depon.*

REKOMANDIMI – 3

- *Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale duhet të shtoj kontrole rreth menaxhimit të SMSF-së që të iniciojë aplikimin e plotë të sistemit të informimit shëndetësor (SISH) përgjatë procesit të furnizimit dhe distribuimit të barnave dhe materialit nga lista esenciale.*

REKOMANDIMI – 4

- *Rekomandojmë që në pranimin e stokut të bllok dëftesave të bëhet regjistrimi në sistemin e informimit shëndetësor në formë të shkruar dhe të dokumentuar mirë, nga ana e zyrtarit për pranim dhe shpërndarje të bllok dëftesave.*

REKOMANDIMI – 5

- *Rekomandojmë që dosjet të paisen me dokumente burimore për të treguar gjendjen faktike të punëtorit*

REKOMANDIMI 6

- *Rekomandojmë që Drejtoria e audituar, Kërkohet të përgadit një regjistër të rreziqeve të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të Drejtorisë.*

Përmbajtja e shkurt drejtuese (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

3.1. Objektivat e këtij Auditimi janë:

1. *Inkasimi dhe realizimi i të hyrave*
2. *Taksat për shërbimet Shëndetësore (në nivel parësor).*
3. *Identifikimi dhe regjistrimi në librin e protokolit*
4. *Tarifat për sektorin e QPS-së*
5. *Shpërndarja e barnave esenciale.*
6. *Mirëmbajtja e dosjeve të punëtoreve.*

3.2. Fushëveprimi i këtij Auditimi ishte si në vijim:

Fushëveprimi i auditimit është gjashtëmujorshi i parë të vitit 2018 duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Identifikimin e të hyrave, shpenzimeve, aktvendimet, regjistrimet, evidentimet, pagesat dhe barazimet.

Periudha e auditimit: 25.06 gjërë 20.07.2018.

Lokacioni: QKMF-ja

1.8 . Emërtimi i auditimit:

Auditimit i Brenshëm në Drejtorin e Administratës së Përgjithshme

Të gjeturat:

1. REZULLTATET

Objektivi kryesor i auditimit

Mbështetur në materialitetin e sistemit të përcaktimit të tarifave nga lëshimi i vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare.

Në planifikimin ton të auditimit kemi parap të auditojmë sistemin planifikimit të të hyrave vetanake, përshtatshmëria e arkëtimeve me tarifat e miratuara dhe grumbullimi i të hyrave vetjake, dhe objektivat e kontrollit të sistemit të dizajnuara nga Menaxhmenti, vlerësimin dhe identifikimin e rreziku dhe efikasiteti dhe efektiviteti në monitorimin e këtij sistemi.

Objektivi ynë i kontrollit është për të siguruar efikasitetin, dhe efektivitetin e kontrollit në menaxhimin e këtij sistemi për të siguruar dhe formuar një opinion lidhur me funksionimin apo mjaftueshmërinë e tij në menaxhimin dhe kontrollin e këtij sistemi për të i ofruar siguri Menaxhmentit të audituar lidhur me funksionimin apo mos funksionimin e kontrollit në këtë drejtim.

1.1. Aplikimi i tarifave në lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare

-Rregullorja për lartësin e tarif ngarkesave 01 nr. 576 të datës 28.02.2017.

Gjatë ekzaminimit në të gjitha kërkesat është respektuar në plotni aplikimi i tarifave për taksa në dhënie e certifikatave dhe dokumenteve të tjera, në bazë të Rregullorës si më lartë.

Përshkrim i shkurtër për këtë sistem

Spektori për gjendjen civile është furnizue me certifikata nga depoja me hyrje- dalje sipas procedurës zyrtare.

Spektori për gjendjen civile gjërë me 30.06.2018 ka pranuar 24.000 certifikata nga depoja, saldoja nga viti paraprak ishte 4.000 cop gjithsejt ishin në përdorim 28.000 cop certifikata.

Çështja 1 - Pranim – Dobësi në lëshimin dhe harmonizimin e certifikatave – prioritet i lartë.

Të Gjeturat

Gjatë rishikimit të certifikatave sipas raportit të daljes së mallrave nga depoja, fatura nr. 72/2018 pa

datë janë tërhequr 16.000 çertifikata, sipas fletngarkimit të mallit me datën 27.06.2018 janë tërhequr 8.000 çertifikata, kurse për 4.000 çertifikata, nuk na është ofruar dëshmi,

nuk kishte dokument as regjister për tërheqjen e çertifikatave nga depoja.

Na është thenë vetëm me gojë që i kemi pranuar 4.000 çertifikata nga depoja

Në depo nuk kishte dalje për tërheqjen e 4.000 cop çertifikata.

Sipas raportit gjërë me 30.06. 2018, nga menaxheri i zyrës civile ishin shpërndar 27.521 çertifikata, nëpër zyre të gjendjes civile në qendër dhe fshatra, mbetja ishte 479 çertifikata, për të cilat nuk kishte regjister të sakt për sasin e mbetur të çertifikatave.

Sipas programit të regjistruara në sistem ishin shpenzuar 26.200 cop çertifikata, diferenca ishte 1.321 cop çertifikata.

KONLUZIONI

Mos regjistrimi dhe harmonizimi i dokumenteve zyrtare, rrit rizikun e besueshmërisë të saktësisë së çertifikatave të pranura të cilat do të shfrytëzohen në vitin në vijim.

4.2. Grumbullimi i të hyrave vetanake

Për të siguruar se Entiteti i audituar ka projektuar kontrollin në menaxhimin e procedurave për grumbullimin e të hyrave vetanake të përcaktuar si pas dispozitave.

Drejtoria e Administratës të Përgjithshme realizon përkatësisht grumbullon të hyra vetanake sipa nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, dhe Rregullores komunale për tarifat , ngarkesat dhe gjokat nga shërbimet dhe veprimtarit komunale nr 576 date 28.02.2017 sipas llojeve të të hyrave të cilat do të i prezantojmë si në vijim:

Pagesat vijuese për tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare ishin sipas Nenit 19 të Rregullorës të cekur më lartë.

Drejtoria e Administratës së përgjithshme realizon të hyra nga Çertifikatat e lindjes, çertifikatat e martesës, çertifikatat e vdekjes, çertifikata e vendbanimit, çertifikatat e shtetësisë, çertifikatat gjendjes martesore. Deklaratat e bashkësisë familjare, lidhjet martesore , çertifikatat tjera ofiqarie dhe nga taksat administrative për fletëkërkesa e tjera.

Ne kemi kryer testimin e një mostre e tërë transaksionesh në vlera të ndryshme , të cilat lidheshin më të hyrat nga Çertifikatat dhe të tjera të cekura më lartë. Kemi bërë vlerësimin dhe rishikimin e procedurave mbi realizimin e të hyrave vetjake, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.

Çështja 2 – Menaxhimi i procesit të inkasimit dhe regjistrimit të të hyrave – Prioritet i lartë

Të gjeturat

Bazuar në informacionet e shpalosura nga evidenca dhe raporti gjashtëmujorsh të parë vitit 2018.

Ne audituam të hyrat e grumbulluara nga tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare, të cilat arrinin vlerën e inkasimit 50.791,00€, kurse planifikimi ishte 100.000,00€.

Realizueshmëria totale e të hyrave ishte 50,79%, ndaj planifikimit, kjo e pasqyron situatën në të gjitha llojet e të hyrave, si trend pozitiv, ka ndikuar që inkasimi total i të hyrave të jetë i knaqshëm.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2.1. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake në raport me Zyrtarin e të hyrave vetanake të komunës. Çështje më rëndësi

Përshkrim i shkurtër për këtë sistem

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Të hyrat e realizuara sipas raportit financiar të zyrtarit të hyrave komunale për periudhën Janar – Qershor të vitit 2018, ishin 50.791,00€, kurse sipas raportit të hyrave të Drejtorisë të audituar të hyrat e realizuara ishin 49.053,00€, diferenca ishte në shumën prej 1.738,00€.

Disa zyrtar të gjendjes civile në fshatra inkasimin e të hyrave për muajin Qershor e kanë kryer në fillim të muajit korrik, shuma e differences nuk është evidentuar në pasqyren financiare me 30.06.2018, është paraqitur mos barazimi dhe harmonizimi të hyrave.

KONKLUZIONI

Mungesa e barazimit dhe harmonizimit me kohë në lidhje me të hyrat përkatëse mund të rezultojë në shpërdorim të të hyrave dhe do të zvogëlojë efektivitetin e proceseve të kontrollit të buxhetit.

4.3. Barazimi dhe harmonizimi i certifikatave të shpenzuara

Zyrtarët të gjendjes civile në qendër dhe fshatra pranë Entitetit të audituar janë të obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për certifikata të shpenzuara në sistemin elektronik me raportin mujor dhe vjetor.

Çështja 3 - Krahasimi dhe harmonizimi i certifikatave – prioritet ilartë

Të gjeturat

Numri i certifikatave të lëshuara sipas sistemit elektronik dhe sipas raportit prej 01.01.2018 gjërë me 30.06.2018,

Numri i kërkesave për certifikata të gjendjes civile sipas zyrtarit shqyrtues ishte 27.077 cop të aprovuara, të refuzuara ishin 127 cop, totali ishte 27.204 cop certifikata.

Sipas evidencës të menaxherit sektorit të gjendjes civile, certifikata të shpërndara ishin 27.521 cop, nëpër zyre të gjendjes civile në qendër dhe në fshatra, diferenca e pa shpenzuar ka mbetur 317 cop certifikata në fund të muajit qershor të vitit 2018.

Zyrtarët e gjendjes civile në qendër dhe fshatra pranë Entitetit të audituar, kanë bërë krahasime dhe harmonizime lidhur me informacionet për certifikata të shpenzuara në sistemin elektronik me raporte

mujore dhe gjashtëmujore.

Procesimi i certifikatave në sistem, është bërë i pa nevojshem në disa raste, sepse sistemi elektronik e regjistron si të rregullt certifikatën e lëshuar.

KONKLUZIONI

Procesimi aktual i informative të sakta për certifikata, harmonizimi dhe krahasimi, parandalojnë gabimet, keq përdorimet të certifikatave dhe marrjen e vendimeve në mungesë të informatave të sakta.

4.4. Përdorimi i Automjetet zyrtare për punë zyrtare

Rregullorës Komunale 01 Nr. 342 të datës 30.01.2013, përcakton shfrytëzimin e automjeteve zyrtare.

Kjo Rregullore Komunale rregullon të drejtat e përdorimit dhe shfrytëzimit të rregull, ekonomik dhe efikas të automjeteve të Komunës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Përshkrim i shkurtër

Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit, ne identifikuam se gjatë rishikimit të Dokumenteve kemi vrejtur se ka mangësi të natyrës praktike, evidenca e dokumenteve për përdorimin e automjeteve zyrtare mbahet në elektronik të instaluar nga zyrtari i njësisë të transportit.

Çështja 4. Procedura e marrjes, mirëmbajtjes, parkimit, servisimit dhe raportimit të automjeteve zyrtare-Prioritet i lartë

Të Gjeturat:

1. Njësia e transportit(zyrtari), ka mbajtur vetëm evidencë mujore për çdo automjet zyrtar lidhur me shpenzimet e derivative të naftës, KM. të kaluar, normativin e shpenzimeve, rezervat e derivateve për bartje.
2. Të dhënat për përdorimin e automjeteve zyrtare dhe shpenzimet janë sjell nga drejtorit.
3. Çdo nëpunës i cili e ka shfrytëzuar Automjetin për udhëtim zyrtar, ka bërë kërkesë vetëm me gojë tek përgjegjësi (eprori) I Drejtorisë ku është i sistemuar, nuk e ka plotësuar formularin apo kërkesën për shërbim të vozitjes të nënshkruar nga eprori i tij, (NENI 7 paragrafi 1 dhe 2).
4. Njësia e transportit (zyrtari) nuk ka ushtruar përgjegjësi që të sigurojë që automjeti të jetë në gjendje të rregullt para përdorimit(NENI 7.5).
5. Njësia e transportit (zyrtari)nuk ka ushtruar përgjegjësi për mirëmbajtjen e autoparkut dhe vend-parkimin e automjeteve zyrtare (NENI 7.6).
6. Njësia e transportit (zyrtari), nuk e bënë inspektimin ditor të automjetit, që të sigurojë drejtuesin e automjetit që automjeti është në gjendje të rregullt para se të nis për udhëtim zyrtar, siç është paraparë në paragrafet e këtij Neni (NENI 8).
7. Të gjitha automjetet të Komunës, pas përfundimit të orarit të punës parkohen dhe qëndrojnë në parkingun e Komunës, kurse çelsat dhe dokumentacioni teknik të automjeteve pas përfundimit

gjatë orarit të punës nuk i dorëzohen zyrtarit të njësisë së transportit.

8. Mos dorëzimi i çelsave dhe dokumentacioni teknik, e bënë të pa mundur ushtrimin e përgjegjësisë të zyrtarit të njësisë së transportit, në automjete zyrtare.

4.4.1. Shpenzimet e derivative të naftës

Çështja 5 Mos arsyetimi i duhur për shpenzimet e derivative të naftës - prioritet i lartë

Përshkrim

Sipas evidencës të njësisë së transportit, Komuna posedon 16 automjete zyrtare, për gjashtëmuajt e parë të vitit 2018, ishin kaluar 84769 kilometra, ishin shpenzuar 7.451,80 litra derivate të naftës, mesatarja e shpenzimit ishte 8,79 në 100 km/h.

Të Gjeturat

Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit, ne identifikuam se gjatë rishikimit të Dokumenteve në shpenzimin e derivative të naftës është gjetur se të njëjtit tip të automjetit, shpenzimet nuk kanë qenë të njëjta.

Të pesë (5) automjete (xhip toyota), shpenzimet e derivative variojnë prej 11,08 litra gjërë në 15,15 litra në 100km/h.

Të tetë (8) automjete (dacia sandero), shpenzimet e derivative variojnë prej 6,27 litra gjërë në 10,34 litra në 100km/h. në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

NR.RE N.	EMËRTIMI	KILOMETRA TË KALUARA	DERIVATET	SHPENZIMET
1	ZYRA E KRYETARIT	11.069	941,8	8,51 - MERCE
2	ZYRA E NËNKRYETARIT	8.563	1.100	12,85- XHIP TO
3	DREJTORIA E ADMINISTRATËS	8.958	640	7,14 - DACIA S 16
4	DREJTORIA E SHËNDETËSISË	6.094	630	10,34 - DACIA S 16
5	DREJTORIA E FINANCËS	5.561	400	7,19 - DACIA 08-16
6	DREJTORIA E FINANCËS	5.028	520	10,35 - XHIP K 07Z-05-16
7	DREJTOEIA E ARSIMIT	7.339	480	6,27 - DACIA S 16
8	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE	4.671	350	7,49 - DACIA S 16
9	DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE	711	100	14,06 - XHIP T
10	DREJTORIA E KADASTRES	3.862	270	6,99 - DACIA S 16

11	DREJTORIA E URBANIZMIT	6.274	460	7,33 - DACIA SANDEF 16
12	DREJTORIA E BUJQËSISË	726	110	15,15 - XHIP TOJOTA
13	DREJTOEIA E EKONOMISË	4.132	390	9,44 - XHIP NISAN T 07Z-18-16
14	DR.O.V.L-UQK-së	2.799	310	11.08 - XHIP TOJOTA
15	DREJTORIA E INSPEKSIONIT	7.017	500	7.13 - DACIA SANDEF 16
16	DREJTORIA E ZJARFIKSEVE	1.965	250	12.72 - XHIP TOJOTA
		84.769	7.451,8	8,79 MESATARJA

Në Rregullorës Komunale 01 Nr. 342 të datës 30.01.2013, për përdorimin e automjeteve zyrtare, gjatë ekzaminimit janë gjetur shumë dobësi në definimin e paragrafit 1 të Nenin 7, dhe në paragrafin 4 të Nenit 9, dhe dobësi të tjera.

KONKLUZIONI

Përdorimi i automjeteve zyrtare në mos pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores Komunale, rrit rrezikun që automjetet e Komunës të keqpërdoren, në mungesë të një politike efektive të menaxhimit të automjeteve është e mundur që shpenzimet e karburanteve të mos janë duke u kontrolluar në mënyrë efektive.

4.5. Zyra e teknologjis informative

Nuk ka të gjetura në këtë drejtim.

4.6. Kërkesat e Qytetareve për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumente zyrtare

Çështja 6 – Dobësi në lëshimin e Kërkesave – prioritet i lartë

Të Gjeturat

Gjatë ekzaminimit të kërkesave është vërtetuar se kishte mangësi të natyrës praktike. Në kërkes nuk evidentohen të gjitha llojet e certifikatave që i kërkon pala.

Zyrtarët e gjendjes civile nuk janë bazuar në kërkesën e pales, sepse pala është shprehur me gojë për llojin dhe numrin e certifikatave të kërkuarara, në mungesë të evidentimit në kërkesë.

4.7. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut

Entiteti i audituar është prituri të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut mbështetur në rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga MFK-ja e obligojnë Entitetin të hartojnë regjistrin e rrezikut i dokumentuar dhe i kompletuar për një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik në menaxhimi administrativ dhe financiar të sistemit.

Çështja 6.-Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut - prioritet të lartë.

Te gjeturat

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut, vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në formë të dokumentuar dhe të shkruar, mos ekzistimin e një regjistri të riskut me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara.

KONKLuzioni

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë performancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtojë ofrimin e cilësisë së performancës së suksesit të mësimëve

Rekomandimet:

REKOMANDIMI- 1

- Rekomandojmë që të bëhet regjistrimi dhe harmonizimi hyrje – dalje të certifikatave me depon. Depoja çdo dokument zyrtar të lëshuar në bazë të kërkesës të krijojë dalje të mallit në baza ditore.

REKOMANDIMI - 2

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar të zbatojë inkasimin e të hyrave Brenda periudhës së caktuar. Që të vie gjërë të barazimi dhe harmonizimi efektiv i të hyrave, në baza mujore në të gjitha rrjedhat e inkasimit..

REKOMANDIMI – 3

- Rekomandojmë që të bëhet procesimi i certifikatave të sakta në sistemin elektronik, duke i krahasuar me raportin mujor, gjashtëmujor dhe vjetor.

REKOMANDIMI – 4

- Rekomandojmë që të respektohet në plotni Rregullorja Komunale 01 Nr. 342 për përdorimin e automjeteve zyrtare.
- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar që menaxhon automjetet zyrtare, të bëjë kërkesë Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për testimin e automjeteve zyrtare.

REKOMANDIMI 5

- Rekomandojmë që në kërkesë të evidentohet të gjitha llojet dhe numri i certifikatave. Sipas kërkesës zyrtari i gjendjes civile të bazohet në lëshimin e certifikatave.

REKOMANDIMI – 6

- Rekomandojmë që menaxhmenti i entitetit të audituar në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për këtë sistem dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll dhe për performancën e arritur në formë të shkruar në baza mujore të raportojë te Menaxhmenti i lartë i komunës (në tekstin e mëtejshëm "Ilogaridhënia").

Përmbajtja e shkurt e drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

1.2. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT:

1. Aplikimi i tarifave në lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtar
2. Grumbullimi i të hyrave vetanake
3. Deponimi i mallrave Hyrje - Dalje në Depo.
4. Përdorimi i Automjetet zyrtare në bazë të udhëzimit administrativ.
5. Formimi i raporteve periodike dhe vjetore.

1.3. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Fushëveprimi i Auditimit është gjashtëmujorshi i parë të vitit 2018, duke përfshir të gjitha dokumentët që kanë të bëjnë me grumbullimi i të hyrave nga taksat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare, identifikimin e raporteve, vendimeve, aktvendimeve, shërbimeve, pagesat dhe barazimin.

Periudha e auditimit 26.07 gjërë 24.08.2018.

Lokacioni: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (sektori për gjendjen civile në qendër dhe në fshatra)

1.9 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Financa dhe Buxhet

Të gjeturat:

2. REZULLTATET

4. 1. Grumbullimi i të hyrave vetanake sipas planit

- a) Për të siguruar se Entiteti i audituar ka projektuar kontrollin në menaxhimin e procedurave për grumbullimin e të hyrave vetanake të përcaktuar si pas dispozitave.

Drejtorja për Financa dhe Buxhet realizon përkatësisht grumbullon të hyra vetanake sipa nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Nr. 03/L-040, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, si dhe nenit 10 të Statusit të Komunës të Rahovecit 01Nr.1005 të datës 29.03.2017, Ligjit nr. 03/L-204 për tatimin në pronën të paluatshme, Ligji Nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-204 të Tatimin në Pronën e pa luajshme, Ligji i ri Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e pa luajshme

Udhëzimin Administrativ nr 3/2011 datë 13.07.2011 si në vijim:

4.2. Të hyrat (përfshirë të hyrat nga tatimi mbi Pronë)

Përshkrimi

Çështja 1- Tatimi në pronë

E gjetura

Drejtorja për Financa dhe Bugjet për vitin 2018 ka planifikuar 340,000,00€, ndërsa ka faturuar 368.900,77€, Deri më 31 09.2018, ka inkasuar 280.171,12€. Kjo tregon se kishte shpërputhje në mes planifikimit për të hyrat nga tatimi në pronë dhe faturimit. Borxhi i akumuluar nga tatimi në pronë vazhdon të mbetet i lartë (1.266.945,59€). Drejtoria e audituar ka një staf kontrollesh që kanë të bëjnë

me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësim në disa procese për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së të hyrave

Të Hyrat

Të hyrat Gjatë nëntëmuorshorit të vitit 2018, Drejtoria për Financa dhe Buxhet ka inkasuar të hyra në vlerë 280.171,12€ apo 82,40% të buxhetit të planifikuar (340.000,00€). Nga tabela më poshtë shohim se fillimisht ka pasur trend të rritjes nga viti paraprak prej 9,95%. Kjo rritje ishte si rezultat i angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave.

Të hyrat e planifikuara dhe të realizuara dhe krahasimi i tyre vitit 2017/2018

EMËRTIMI	Plani vjetor i të hyrave për vitin 2018	Realizimi vitit 2017 (janar-shtator)	Realizimi i vitit 2018 (janar-shtator)	Progresi ndaj planit vjetor vitit 2018	Progresi ndaj realizimit vitit 2017
	A	B	C	$D=(C/A)*100$	$E=(C/B)*100$
Të Hyrat	340.000,00	252.302,24	280.171,12	82,40	111,05

KONKLuzioni

Dallimi ndërmjet planifikimit, faturimit dhe realizimit, tregon planifikim jo real të tatimit në pronë. Mos konsistenca e procesit në fushën e të hyrave ndikon në pamundësinë e planifikimit të projekteve për t'u financuar nga burimet vetjake, apo shfaqjen e suficiteve/deficiteve të hyrave në fund të vitit. Po ashtu, mos përditësimi i bazës së tatimpaguesve dhe mos verifikimi i pronave totale të tatueshme, rritë rrezikun që komuna të mos i ngarkoj në mënyrë adekuate pronat aktuale dhe të diskriminojë obliguesit të cilët paguajnë tatimin në pronë.

Çështja 2 – Mos verifikimi i 1/3-tës (1/5 tës), të pronave nën menaxhim të komunës

E gjetura

Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 03/2011 neni 13 - verifikimi në teren i pronave, zyra Komonale e tatimit në pronë është e obliguar që çdo vit të bëjë verifikimin në teren të 1/3-tës së pronave të regjistruara. Sipas regjistrave të Zyrës Komonale për tatimin në pronë Gjërë në fund të muajit Shtator të vitin 2018, kishte regjistruar me GPS- dhe me aparat, Objekte të reja gjithsejt- 1064, me një sipërfaqe prej 191374M/2, kishte shpërndar 13123 fatura, prej tyre 6607 fatura ishin të paguara. Ishte bërë verifikimi vetëm 6,26%, në 822 objekte, në një sipërfaqe 191374 m/2. Në vitin 2017 zyra e tatimit në pronë i kishte regjistruar me GPS- dhe me aparat Objekte të reja gjithsejt- 315 me një sipërfaqe prej 55384 M/2, kishte shpërndar 13075 fatura, prej tyre 7756 fatura ishin të papaguara. Ishte bërë verifikimi vetëm 3,40%, në 444 objekte, në një sipërfaqe 65408m/2.

Zyra e tatimit në pronë nuk kishte arritur të kryej ri-anketimin për verifikimin e 1/3-tës (1/5 tës) së pronave të regjistruara, siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204, Ligji nr.04/L-100 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronë e pa Luajtshme. Tani Ligji i ri nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e pa luajtshme dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Mungesa e ri-

anketimit ishte si pasojë e mungesës të zyrtarëve anketues në terren për verifikimin e pronave dhe grumbullimin e informatave.

KONKLUSIONI

Mos verifikimi i 1/3-tës të pronave mund të rezultojë me informata të paplota të pronës së tatueshme aktuale, pasi nuk përfshihen ndryshimet në prona si dhe mund të ketë humbje potenciale financiare nga inkasimi më i ulët.

Çështja 3 - Kushtëzimi i pagesës së tatimit mbi pronë

E Gjetura

Drejtoria për Financa dhe Buxhet pjesërisht e ka zbatuar kushtëzimin e pagesës së tatimit në pronë sipas Udhëzimit Administrativ 07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për ndryshimin e pagesës së tatimit në pronë, neni 7 që detyron mos ofrimin e shërbimeve komunale ndaj tatimpaguesve që nuk paguajnë detyrimet, janë dhënë vërtetime dhe certifikata, nga zyrtaret për dhënjën e certifikatave, pa i kushtëzuar për kryerjen e detyrimit, ka ndikuar që tatimpaguesit mos ti kryejn detyrimet ndaj tatimit në pronë.

Ishin 88 tatimpagues që nuk e kishin paguar detyrimin mbi 1.000,00€ në një shumë prej 139.773,80€

KONKLUSIONI

mos kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve me pagesën e borxheve aktuale e ulë mundësinë e inkasimit të borxheve.

4.2.2. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave vetanake në raport me Zyrtarin e të hyrave vetanake të komunës. Çështje më rëndësi

a) Për të siguruar se zyrtari i të hyrave vetanake në baza mujore ka proceduar krahasuar dhe harmonizuar informacionet e të hyrave të entitetit të audituar me zyrtarin komunal të të hyrave.

4.3. Subvencionet dhe transferet

Buxheti për subvencione të planifikuara në vitin 2018 ishte 191.322,00€. Prej tyre ishin shpenzuar 155.186,07€ apo 81,11% të buxhetit final. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive apo ndihma momentale.

Çështja 4 – Mungesa e dëshmime kthyesë për arsyetimin e subvencionit.

E gjetura

Në shtatëmbëdhjet raste përfituesit e subvencioneve në vlerë totale 62.000,00€, nuk kishin përgatitur raporte financiare dhe nuk kishin ofruar dëshmi, të cilat do të dëshmonin se subvencioni është shfrytëzuar për qëllimin e dhënë. Rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr. 463-720/2017 të datës 23.05.2017, për ekzekutimin e kontratës për ndarjen e mjeteve financiare Neni 4 pika 3, të nënshkruar nga Kryetari, përcakton që përfituesi i subvencionit duhet të dorëzojë raport tremujor/gjysmë-vjetor/ raport vjetor për zbatimin në afat prej: 15 ditë pas skandimit të periudhës së raportimit, një raport kthyes zyrtar të shpenzimeve, të financuesi sipas formularëve të paraparë.

KONKLUSIONI

Mos raportimi i përfituesve të subvencioneve lidhur me realizimin e projekteve të subvencionuara rrit rrezikun që mjetet të shfrytëzohen për qëllime tjera, dhe si rrjedhojë mund të ndikon në dëmtimin e buxhetit.

Parat e gatshme (pety cash)

Rregulla financiare dhe Udhëzimi i Thesarit – 02 shpenzimi i parashë publike, neni 9.3 vendos rregullat për përdorimin e parashë së imtë.

Tërheqja e parave të gatshme ishte bërë në shumën prej 5.000,00€.

Nuk kemi të gjetura në këtë drejtim.

4.4. AVANSET

Udhëzimit Administrativ nr. 2009/4 për udhëtime zyrtare.

Neni 3 paragrafi 2 të U.A. si më lartë, përcakton kërkesën për kompensim dhe për meditje se bashku me dëshmitë për shpenzime financiare të udhëtimit zyrtar i dërgohet shërbimit për Buxhet dhe Financa në MAPL më së largu 5 ditë pune nga data e përfundimit të udhëtimit zyrtar, ndërsa avanset mbyllen më së largu 15 ditë pune pas përfundimit zyrtar.

Nuk kemi të gjetura në këtë drejtim.

4.5. Obligimet e pa paguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në vlerë prej 2.243.767,00€, ishin në fund të vitit 2017. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Kjo vlerë e obligimeve të papaguara është rezultat i kontroleve të brendshme të pamjaftueshme dhe hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Çështja 5 - Niveli i lartë i obligimeve të pa paguara

E gjetura

Komuna nuk ka menaxhuar si duhet obligimet ndaj furnitorëve. Obligimet e papaguara datojnë që nga vitet paraprake dhe vitet pasuese. Ato nuk janë paguar për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Gjithashtu janë evidentuar edhe vonesa në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve. Sipas Rregullës Financiare 01-2013, MF- Shpenzimi i parave publike Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Sipas raportit të shpenzimeve të pa paguara gjerë në fund të muajit shtator të vitit 2018, kanë mbetur obligimet të pa paguara në shumën prej 99.147,17€.

KONKLUSIONI

Kontrollet jo të mira në menaxhimin e obligimeve rrisin rrezikun e hyrjes në obligime pa mbulesë buxhetore apo përballje me drejtësinë duke krijuar edhe shpenzime shtesë dhe vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

4.6. Regjistri i rrezikut

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, përshkrimin e rrezikut, vlersimin e rrezikut, veprimet që duhet të ndërmerren dhe planin kohor, mbështetur në rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga MFK-ja

Çështja 6 -Moszbatimi i kërkesave për regjistrin e rrezikut çështje më prioritet të lartë.

Te gjeturat

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një proces për regjistrin e rrezikut, me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara.

KONKLUZIONI

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëloj performancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së performancës së suksesit të mësimave.

Rekomandimet:

REKOMANDIMI - 1

- Drejtoria e audituar duhet të sigurohet që planifikimi i buxhetit për vitin vijues të jetë i bazuar në inkasimet e vitit aktual, në mënyrë që të hyrat të jenë konform planifikimit dhe pritshmërisë së inkasimit.

REKOMANDIMI - 2

- Drejtoria e audituar duhet të siguroj mekanizma efektiv për verifikimin e kuotës së përcaktuar prej 1/3-tës (1/5 tës), së pronave për tatimin në pronë siç kërkohet me udhëzimin administrativ.

REKOMANDIMI- 3

- Rekomandojm që të sigurohet që ankëtimet, vlersimi dhe kushtëzimi i pagesës së tatimit në pronë të shërbimeve bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 dhe Nr. 07/2011 dhe 04/2011.

REKOMANDIMI - 4

- Rekomandojm që Drejtoria përkatëse duhet të sigurojë se përfituesit e subvencioneve të raportojnë për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve, dhe në rastet kur mjetet nuk shfrytëzohen për qëllimin e dhënë të ndërmerren masa ligjore ndaj përfituesve të subvencioneve.

REKOMANDIMI - 5

- Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se të gjitha pagesat realizohen brenda 30 ditëve pas pranimit të faturës siç kërkohet me LMFFPP.

REKOMANDIMI – 6

- Rekomandojm që Menaxhmenti i Drejtorisë të audituar të formoj regjistrin e rrezikut për identifikimin , vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për këtë sistem dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

3. Fushëveprimi dhe objektivat e këtij auditimi janë:

Fushëveprimi:

Fushëveprimi i auditimit është Nëntëmuorshi të vitit 2018, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me: Indetifikimin e të Hyrave, Shpenzimeve, , Regjistrimet, Evidentimet , Pagesat dhe Barazimet.

4. OBJEKTIVAT KRYESORE TË AUDITIMIT:

1. *Inkasimi dhe realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë.*
2. *Shpenzimet*
3. *Dhënja e Avanseve*
4. *Shpenzimi i Paras së gatshme*
5. *Ndarja e subvencioneve në bazë të rregullorës*

1.10 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike , Komunale

Të gjeturat:

4. REZULTATET

Auditimi ynë është fokusuar në rishikimin e prezantimit dhe shpalosjen e taksave për shfrytëzimin përkohshëm të hapësirës publike, vendosjen e objekteve të përkohshme dhe në kryerjen e testimeve substanciale për të konfirmuar saktësinë dhe validitetin e taksave për shfrytëzimin e përkohshëm hapësirës publike.

4.1. REALIZIMI I TË HYRAVE

Drejtoria e Shërbimeve Publike Komunale ka vendosur disa kontrole mbi të hyrat, megjithatë, ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme sidomos në planifikimin, në nxjerrjen dhe aplikimin e politikave dhe mekanizmave adekuat në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga shfrytëzimi i pronës publike, vendosja e objekteve të përkohshme dhe borxhet tjera.

Në bazë të Rregullorës nr. 576 të dates 28.02.2017, realizon të hyra nga Taksat për Gërmim, taksat tjera administrative, taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, qiraja nga objektet e përkohshme, dhënja e lejes për autotaxi dhe linja për autobusa.

Kemi bërë vlerësimin dhe rishikimin e procedurave mbi realizimin e të hyrave vetjake, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor. Për vitin 2018 ishin planifikuar të hyra në shumën prej 425.000,00€, (25.000,00€) derisa shuma e inkasuar ishte në shumën prej 15.843,76€, progresi ndaj planit ishte 3,73%, (apo 63,38%).

Çështja 1 – Mangësi në Planifikimin, regjistrimin dhe realizimi e të hyrave

Të Gjeturat:

Planifikimi i të hyrave ishte jo i drejt te kategoritë që nuk janë burim të të hyrave në këtë Drejtori.

Sipas zyrtarit të hyrave pranë Drejtorisë për financa dhe bugjet, në raportin financiar i planifikimit dhe realizimit të të hyrave buxhetore për periudhën Janar – Dhjetor vitit 2018, ishin përfshir të hyrat nga taksat komunale për leje ndërtimi të planifikuara ishin në shumën prej 2.000,00€, nuk kishte inkasim në këtë drejtim, taksat për demolim (Gërmim) nuk kishte të planifikuar, të inkasuara ishin 358,00€, licenca për aktivitete individuale (Leja (vazhdimi) i punës për auto-taxi dhe kombibus) ishte një planifikim shumë i lartë në shumën prej 400.000,00€, kurse të inkasuara ishin 406,00€. Këto tri kode të të hyrave ishin emërtuar gabimisht si të hyra në raportin financiar, Madje të hyrat e realizuara në këtë kod të të hyrave janë evidentuar gabimisht në SIMFK., është njoftuar zyrtari kryesor i të hyrave komunale, nga zyrtari i të hyrave të Drejtorisë së audituar, që të emrohen të hyra në bazë të Rrtegullores në fuqi dhe të inkasohen të hyrat në kode përkatëse në raportin financiar, nuk ka përmirësim në këtë drejtim.

KONKLUZIONI

Nevojat e shumta për përshtatje, janë tregues që përgatitja e planifikimit nuk është bazuar në analiza dhe vlerësime reale nga Drejtoria e audituar. Mos eaktimi i planifikuar në bazë të ngarkesës nëpër kategori mund të ndikojë në mos arritjen e objektivave.

4.1.1. Barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me Zyrtarin e të hyrave të komunës - Çështje në rëndësi

Zyrtari i të hyrave pranë Entitetit të audituar është i obliguar që në përditësore dhe sistematike dhe në baza mujore në formë të shkruara të i krahasoj dhe harmonizoj informacionet për të hyrat vetjake të realizuara me zyrtarin e të hyrave komunale.

Të Gjeturat

Zyrtari i të hyrave pranë drejtorisë të audituar ka bërë barazimin e të hyrave, ka kërkuar të bëjë krahasimin dhe harmonizimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave komunale, nuk ka ndryshuar as gjë në këtë drejtim

4.2. Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsires publike për kryerjen e veprimtaris së tyre, subjektet afariste të regjistruara. (Shfrytëzimi i pronës publike me kod 50405)

Ishin 59 subjekte afariste që e shfrytëzojnë hapsiren publike dhe që kanë lidhur kontratë të përkohshme. Duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga zyra e shërbimeve publike, Drejtoria e audituar për vitin 2018, kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 12.000,00€, ndërsa kishte inkasuar 12.760,16€, progresi ishte 106,33%.

Çështja 2 - Mos respektimi i kontratës së përkohshme

Të Gjeturat

Për vitin 2018 ishin 80 kërkesa për shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike, Të aprovuara ishin 59 dhe janë furnizuar me kontratë të përkohshme
Disa kontraktues të përkohshëm të hapësirës publike nuk e kanë respektuar kontratën kanë shpërdëruar hapsira publike që nuk janë përfshirë në kontratë.
Drejtorja për punë inspektuese në bazë të procesverbaleve, ka ngritur aktvendim për marrjen e masave për

mos rrespektim të kontratës së përkoheshme.

Drejtoria për punë inspektuese në bazë të aktvendimit, në teren ka vepruar në konfiskimin e mallit të dy shfrytëzuese, ishte faza e parë e veprimit.

KONKLUSIONI

Dhënia në shfrytëzim të hapsirës publike me kontratë, eliminon mundësinë e pjesëmarrjes, në sipërfaqe publike pa kontratë. Dobësitë e identifikuar në mos menaxhimin e kontratave për shfrytëzimin e hapsirës publike rezultojnë në uzurpimin e sipërfaqës publike dhe reduktojnë aftësinë e Drejtorisë për inkasimin e të hyrave nga burimet vetjake.

1.3. Taksat për vendosjen e Objekteve të Përkohshme (qiraja nga objektet publike me kod 50408)

Duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga zyra e shërbimeve publike, të hyrat e planifikuara ishin 10.000,00€, të inkasuara ishin 1.530,60€.

Çështja 3 - Mos inkasimi i duhur i të hyrave nga taksa e veprimtarisë

Të Gjeturat

Të inkasuar ishin në vlerë 1.530,60€ progresi ndaj planit ishte shumë i ulët 15,31%, sepse taksat nga vendosja e objekteve të përkohshme nuk është bërë e hyrë në kodin e caktuar, dhe ishin të inkasuar gabimisht në SIMFK..

Borgjet nga vitet paraprake ishin inkasuar, përveq katër(4) shfrytëzues që nuk ju kan përgjigjur obligimit, për të cilët Drejtoria e audituar ka kryer procedura administrative për largimin e objektit, . Drejtoria për punë inspektuese ka qenë azhur në procedurat administrative për mbylljen e objekteve të përkohshme, Borgji për vitin 2018 ishte 3.264,50€.

KONKLUSIONI

Kontrollet kërkohen të forcohen në menaxhimin për vendosjen e objekteve të përkohshme, që të evitohen mangësi në këtë drejtim, të cilat e rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre.

4.4. MENAXHIMI I PROJEKTEVE

Projektet janë mënyrë e veçant e zhvillimit dhe formë e rëndësishme për realizimin e qëllimeve të definuara në planet zhvillimore të vendit, lokalitetit, kompanisë.

Projektet sigurojnë shfrytëzimin racional të fondeve dhe resurseve të rralla, i kontribuojnë rritjes së të ardhurave, qëndrueshmërisë ekonomike, si dhe cilësisë më të mirë të jetesës përgjithësisht. Plotësimi i këtyre objektivave kryesorë varët se në çfarë shkalle përmbushën parametrat e planifikuar të projektit.

Një projekt është një detyrë unike, e përkohshme, komplekse dhe me qëllim të caktuar, me përshkrim të sakta të detyrave dhe resurse të definuara.

Çështja 3 - Mos kryerja e projekteve

Të Gjeturat

Ishin 38 projekte të planifikuara, prej tyre ishin 31 projekte në vazhdim të viteve paraprake.

7 projekte ishin të vitit 2018, (4 kontrata ishin të lidhura kurse 3 kontrata ishin në procedur të inicimit), 16 projekte ishin të përfunduara.

Projektet e pa përfunduara ishin 15 që nga viti 2012 e gjërë në vitin 2017

KONKLUSIONI

Projektet jo të kryera është në kundërshtim me marrëveshjet, kalojnë përtej planifikimeve buxhetore dhe në mungesë të mjeteve, përcillen me implikime buxhetore për komunën e cila sfidohet me obligime të shumta pa mbështetje financiare me ndikim në vonesa të realizimit të projekteve.

Rekomandimet:

REKOMANDIMI - 1

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë që të bëhen analiza dhe vlerësime në planifikim në bazë të ngarkesës së taksës, për të siguruar të hyrat në kode të inkasohen ashtu siç është planifikuar.

REKOMANDIMI - 2

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të ndalojë shfrytëzimin e sipërfaqes publike që nuk është e përfshirë në kontratë.

REKOMANDIMI - 3

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar në bashkëpunim me Drejtorin për punë inspektuese, kontrollet të i forcojnë në mënyrë që të mirrën masa me anë të procedurës administrative për largimin e objekteve të përkohshme, shfrytëzuesit që nuk e respektojnë kontratën.

REKOMANDIMI – 4

Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se projektet të kryhen në përputhje të plotë me marrëveshjet e bëra me palët e ndërlidhura me qëllim të evitimit të implikimeve financiare që shkaktohen më tej gjatë realizimit të tyre.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2. Fushëveprimi i këtij auditimi është :

- Realizimi i të hyrave nga Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsires publike dhe vendosja e objekteve të përkohshme për nëntëmujorshin të vitit 2018.

3. Objektivat:

- Inkasimi dhe Realizimi i të hyrave vetanake
- Taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të hapsires publike për kryerjen e veprimtarisë së tyre, subjektet afariste të regjistruara.
- Taksat për vendosjen e objekteve të përkohshme (Baraka, kioska etj.)
- Taksat për dhënie me qira të hapësirës publike dhe aseteve nëntokësore për shfrytëzimin komercial.
- Menaxhimi i Projekteve

1.11 . Emërtimi i auditimit:

Auditimi i brendshëm në Zyrën e Prokurimit

Të gjeturat:

1. REZULLTATET:

Ligji i Prokurimit Publik nr. 04/L-042 përcakton kërkesat të cilat duhen të respektohen për shfrytëzimin e mjeteve publike në aktivitetin e prokurimit. Procesi i prokurimit përbëhet nga tri grupe kyqe të aktiviteteve si përgatitja e procesit të prokurimit, zhvillimi i procesit dhe menaxhimi i kontratës. Për të rezultuar suksesshëm secili proces i prokurimit duhet ti ndjek këto aktivitete. Zyra e prokurimit për nëntëmujorin e vitit 2017 për investime kapitale, kishte planifikuar që përmes procesit të prokurimit të nënshkruaj kontrata në vlerë prej 1.157.291,00€. Ne rishikuam procesin e shpenzimeve përmes prokurimit, prej inicimit të aktiviteteve të prokurimit, menaxhimit e procesit e deri në finalizimin e kontratave. Për të nxjerrë një konkluzion lidhur me mbarëvajtjen e procesit të prokurimit, ne testuam 60% të kontrata minimale, të vogla, të mesme dhe me vlerë të madhe me një shumë prej 2.186.943,02€ apo 46,62% të totalit të vlerës së kontratave të nënshkruara.

Objekti kryesor i auditimit

Mbështetur në materialitetin e sistemit të përcaktimit të aktiviteteve si përgatitja e procesit të prokurimit, zhvillimi i procesit dhe menaxhimi i kontratës. në planifikimin ton të auditimit kemi parap të auditojmë sistemin planifikimit të prokurimit, përgatitja e procesit të prokurimit, zhvillimi i procesit, menaxhimi i kontratës dhe objektivat e kontrollit të sistemit të dizajnuara nga Menaxhmenti, vlerësimin dhe identifikimin e rrezikut dhe efikasiteti dhe efektiviteti në monitorimin e këtij sistemi.

Objekti ynë i kontrollit është për të siguruar efikasitetin, dhe efektivitetin e kontrollit në menaxhimin e këtij sistemi për të siguruar dhe formuar një opinion lidhur me funksionimin apo mjaftueshmërinë e tij në menaxhimin dhe kontrollin e këtij sistemi për të i ofruar siguri Menaxhmentit të audituar lidhur me funksionimin apo mos funksionimin e kontrollit në këtë drejtim.

3.1 A është bërë zbatimi i procedurave prej inicimit të aktivitetit të prokurimit e deri tek përmbartimi i kontratës publike, në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit të prokurimit publik.

2.1.1. PLANIFIKIMI I PROKURIMIT

Sipas Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Planifikimi i Prokurimit është proces i ndërmarrë nga Autoriteti kontraktues për të planifikuar aktivitetin për një periudhë kohore prej 12 muaj.

Planifikimi i Prokurimit kërkohet, Brenda 15 diteve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal, secili AK. i cili është autoritet publik ose ndërmarrje publike, do të përgadit, do të publikoj në webfaqën e autoritetit përkatës kontraktues dhe të njëjtën do të dorëzoj në Axhensin Qendrore të Prokurimit, Autoriteti Kontraktues përdor platformën elektronike për të dorëzuar Planifikimin final të

Prokurimit

Në planifikim janë përfshir - 11 kontratat për furnizim, 6 kontrata për shërbime dhe 37 kontrata për punë gjithsejt janë parapar 54 kontrata në një vlerë prej 2.254.368,38, dhe një (1) Konkursset e projektimit në një vlerë prej 70.000,00€.

Në Raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2018, ishin të parapara 78 kontrata publike me vlerë minimale, të vogla, të mesme dhe me vlerë të madhe me një vlerë të kontraktuar prej 6.854.477,76€, prej tyre ishin 8 kontrata jo të kontraktuara dhe 6 kontrata të anuluar.

Planifikimi i prokurimit duhet të jetë konform buxhetit të AK. Për vitin fiskal në fjalë. Kur bëhet fjalë për kontrata shumë-vjeqare duhet të ketë "bazë të arsyeshme që aprovimi i buxhetit do të bëhet" për AK. Në vitet e ardhëshme përkatëse fiskale.

Për të kryer një planifikim të prokurimit, zyrtarit të prokurimit do ti nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me Departamentin e Buxhetit dhe të tjera.

Çështja 1 - Mos përfshirja e projekteve në planin e prokurimit

E gjetura

-Ne kemi vërejtur se zyrtari i prokurimit ka përgatitur planifikimin final të prokurimit konform kërkesave ligjore që rrjedhin nga Ligji i prokurimit publik dhe ligjeve sekondare edhe përkundër një progresi në procesin bashkëpunimit dhe koordinimit me departamentet relevante e kundërta e kësaj kemi vërejtur se kontrolli ka treguar disa dobësi të vogla që gjeneron një planifikim që nuk është në harmoni të plotë me aktivitetet e prokurimit që qojnë në dhënie të kontratës publike.

Planifikimi i prokurimit për furnizime është në vlerë prej 236.674,38€, për shërbime në vlerë prej 301.000,00€, për punë në vlerë prej 1.716.694,00€ dhe në total vlera e parashikuar e prokurimit është prej 2.254.368,38€, dhe një(1) Konkursset e projektimit në një vlerë prej 70.000,00€, gjithsejt totali ishte 2.324.368,38€.

Sipas Raportit vjetor gjërë me datën e auditimit Kontratat e nënshkruara publike ishin 64 në një vlerë prej 6.854.477,76€, diferenca ndaj planifikimit ishte në vlerën prej 4.530.109,38€

12 Kontrata të parashikuara për punë nuk janë përfshirë në aktivitetet e prokurimit që qojnë në dhënie të kontratës publike si më poshtë:

"Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore" në vlerën prej 52.359,00€, "Ndërtimi i shtatoreve të Hërojneve" në vlerë prej 60.000,00€, "Ndarja e mjeteve për emergjenca të ndryshme në bujqësi" në vlerë prej 15.000,00€, "Kullimi i tokave bujqësore në fshatra" në vlerë prej 100.000,00€, "Intervenimet emergjente të infrastrukturës" në vlerë prej 50.000,00€, "Rregullimi i varrezave në Komunën e Rahovecit" në vlerë prej 80.000,00€, "Investimet në hapsirat e jashtme në depot në xërëxe" në vlerë prej 10.000,00€, "Menaxhimi dhe mirëmbajtja e mbeturinave të ngurta" në vlerë prej 20.000,00€, "Ndërtimi i rrugës Brestoc – Hoq e madhe" në vlerë prej 33.000,00€, Ndërtimi i shkollës në Fshatin Retijë" në vlerë prej 40.000,00€.

KONKLuzioni

Realizimi i projekteve jashtë planifikimeve fillestare mund të çrregulloj projeksionet buxhetore, dhe të ndikoj në mosrealizimin e projekteve të planifikuara me planin vjetor të prokurimit.

Inicimi i aktiviteteve të prokurimit çështje më rendësi.

Kriteri: për të u bindur dhe siguruar se inicimi i aktivitetit të prokurimit është procedura në përshtatshmëri me neni 8 paragrafët 1,2, 3,4 ,5 të Rregullave dhe UOPP

Përshkrim i sistemit

Zyrtari përgjegjës i zyrës së prokurimit do të filloj me iniciimin e aktiviteteve të prokurimit vetëm atëherë pasi të siguroj nga njësia e kërkesës, deklaratën e nevojave dhe përcaktimin e disponueshmërisë së fondeve dhe miratuar nga ZKA dhe konfirmuar nga ana e ZKF se fondet janë të alokuara dhe autorizimi e një zyrtari i cili do të autorizoj zyrtarin e prokurimit me kërkesën e miratuar për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit.

Po qe se aktiviteti i prokurimit nuk është paraparë në planifikimin final të prokurimit një kopje e formularit do të dërgohet nga ZKA tek AQP të paktën 5 ditë para se të filloj me autorizimin për iniciimin e aktiviteteve të prokurimit.

Përshkrim

Zyra e prokurimit para iniciimit të çdo aktiviteti të prokurimit ka siguruar paraprakisht Deklaratën e nevojave dhe përcaktimin e disponueshmërisë së fondeve të përgatitura nga njësia e kërkesës dhe miratuar nga kryetari i komunës, kërkesën për iniciim të procedurës së prokurimit nga aga autorizuesit për iniciim ,dhe kalkulimin e kontratave të parashikuara,paramasave ,specifikimeve teknike të obligueshme në sasi dhe vlerë financiare si dhe me kohë ka filluar me iniciimin e aktiviteteve të prokurimit gjithnjë në përshtatshmëri me rregullat që rrjedhin nga LPP dhe ligjet dytësore për këtë sistem.

Bazuar në mostrat që i kemi marr për testim dhe gjatë në ekzaminimi dhe analizimi të detajuar kemi ardhur në këtë:

Përfundim

Për këtë proces(sistem) nuk kemi ndonjë të gjetur që vlen të theksohet.

3.1. Procedurat e prokurimit të kontratave më vlerë minimale,vogël,mesme dhe të lartë për punë, shërbime dhe furnizim

Objektivi i auditimit

Ne në planifikimin e tonë të angazhimit kemi pasur për objektiv vetëm auditimin e procedurave që janë udhëhequr për kontratat me vlerë të mesme dhe të mëdha për punë,shërbime dhe për furnizime.Duke parë rendësin ne evitimim e ndarjes së kërkesave të cilat konsiderohen që janë të natyrës së njëjtë apo ekuivalente ne në vijim do të konstatojmë lidhur me efikasitetin dhe efektivitetin,progresin dhe performancën si njësi matëse në performancën përkatësisht dobësitë eventuale në vlerën totale të të gjitha llojet e kontratave të nënshkruar.

Kriteri: Për të u bindur dhe siguruar se entiteti i audituar ka udhëhequr procedurat e prokurimit në përshtatshmëri me Ligjin e prokurimit me plotësime dhe ndryshime si dhe ligjet dytësore të përgatitur dhe miratuar nga ana e KRPP.

Përshkrim

Zyra e prokurimit gjatë periudhës së auditimit bazuar në kërkesat e njësive të kërkesave ka udhëhequr procedurat e prokurimit për të gjitha llojet e kontratave si për furnizim,shërbime dhe punë dhe ka nënshkruar kontrata bazë dhe kontrata shtesë në total prej 6.854.477,76€,

Konkluzion i përgjithshëm për këtë sistem

Sipas konkluzioneve tona zyra e prokurimit për periudhën audituese ka treguar një progres inkurajues

në mbledhjen e kërkesave ku ka qenë e mundshme dhe zvogëlimin dhe evitimin e kërkesave të prokurimit që janë kryesisht të natyrave të njëjta apo ekuivalente qo të të ketë ndikim për të fituar vlerën për para dhe reduktuar kohën efektive dhe kostot e udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Çështja 2 - Mungesa e lejeve të ndërtimit, mbikëqyrjes inspektive dhe lejes së përdorimit

E Gjetura

Sipas ligjit të ndërtimit, me rastin e kontratave ndërtimore kërkohet pajisja me dokumentacionin përkatës siç është leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive si dhe leja e përdorimit. Komuna në 11 kontrata, nuk kishte aplikuar lejet ndërtimore dhe mbikëqyrjen inspektive si më poshtë:

“Ndërtimi i rrugës Krush e madhe - Randubravë”, “Ndërtimi i serave me participim”, “Riparimi i Objekteve Shëndetësore”, “Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik në Komunën e Rahovecit”, “Ulja e niveletës së proit në fshatin celinë”, “Ndërtimi i objektit të qerdhës së fëmijëve në fshatin Ratkoc”, “Ndërtimi i SHMFU “Herajt e Kosovës” në Hoqë të Vogël – Brestoc”. “Ndërtimi i Rrugëve në Komunën e Rahovecit”, “Ndërtimi i Kanalizimit në Komunën e Rahovecit”,

KONKLuzioni

Inicimi i projekteve në mungesë të kompletimit të dokumentacionit sipas kërkesave të ligjit për ndërtim, mund të ndikojë në cilësinë dhe ngecen në realizimin e këtyre projekteve.

Çështja 3 – Kontraktim i punëve pa zotimin e plotë të mjeteve

E gjetura

Sipas Rregullës Financiare 01/2013, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak dhe se zotimi duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës. Kontrata e lidhur me datën 20.04.2018 “Furnizimi me gjenerator dhe pjesë përcjellëse për nevojat e repartit të dializes” e datës 20.04.2018 në vlerë prej 16.480,00€, ishte nënshkruar me zotimin jo të plotë të mjeteve, ishin zotuar me datën 12.02.2018 në shumën prej 15.000,00€, kurse në shumën prej 1.480,00 ishin zotuar pas pranimit të faturës me datën 22.05.2018.

Kontrata e lidhur me datën 17.07.2018 “Shtigjet e ecjes në Rahovec” në vlerë prej 129.744,00€ zotimi ishte jo i plotë në vlerë prej 135.500,00€. Kontrata e lidhur me datën 17.07.2018 “Ndërtimi i serave me participim” në vlerë prej 287.593,90€ zotimi ishte jo i plotë në lidhjen e kontratës, në vlerë prej 80.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 15.08.2018 dhe me 20.08.2018 “Meremetimi i rrugëve dhe trotoareve” në vlerë prej Loto – I-149.418,40, Loto II- 87.765,00, Loto III- 128.110,00€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 10.791,49€.

Kontrata e lidhur me datën 18.06.2018 “Ndërtimi i palestrës sportive në Komunën e Rahovecit” në vlerë prej 628.545,28€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 170.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 08.08.2018 “Riparimi i Objekteve Shëndetësore” në vlerë prej 31.452,68€, dhe Aneks kontrata me datën 11.12.2018, në vlerë prej 3.038,00€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 20.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 26.09.2018 “Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik në Komunën e Rahoveci” në

vlerë prej 128.526,00€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 20.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 06.09.2018 “ Ulja e niveletes së proit në fshatin celinë”, në vlerë prej 176.086,10€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 30.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 20.11.2018 “Ndërtimi i objektit të qerdhës së fëmijëve në fshatin Ratkoc”, në vlerë prej 468.292,23€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 15.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 26.11.2018 “Ndërtimi i SHMFU “Herojt e Kosovës” në Hoqë të Vogël – Brestoc” në vlerë prej 464.298,82€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 40.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 02.11.2018 “ Kullimi i tokave Bujqësore në Xërxe” në vlerë prej 148.325,14€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 35.000,00€.

Kontrata e lidhur me datën 03.12.2018 “Ndërtimi i Rrugëve në Komunën e Rahovecit” në vlerë prej 271.388,20€, zotimi ishte jo i plotë para lidhjes së kontratës, në vlerë prej 131.511,62€.

KONKLuzioni

Nënshkrimi i kontratës në mungesë të zotimit të mjeteve, rrezikon mos përmbushjen e kontratës apo zbatimin e vonshëm të saj dhe në këtë mënyrë mosarritjen e objektivave të komunës.

Çështja 4 – Mosrespektim i legjislacionit përkatës në formimin e komisioneve të vlerësimit.

E gjetura

Sipas nenit 40 të rregullës dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik, komisioni vlerësues formohet prej rastit në rast nga Zyrtari Kryesor Administrativ me rekomandim nga zyrtari përgjegjës i prokurimit. Më tutje, numri i anëtarëve që marrin pjesë në komisionet e vlerësimit duhet të jetë tek (tre e ma shumë anëtar). Komisioni vlerësues është formuar disa ditë më herët për vlerësimin e tenderit.

KONKLuzioni

Mos formimi i komisioneve prej rastit në rast siç kërkohet me rregullat dhe udhëzuesit operativ të prokurimit publik rrit rrezikun që anëtarët e caktuar në komisionet përkatëse të mos jenë kompetent për punën e caktuar.

Çështja 5- Në paramas dhe parallogari të parashikuara vendosja e çmimeve të larta

E gjetura

Kontrata e lidhur “ Shtigjet e ecjes në Rahovec” Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë prej 218.588,50€ sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 17.07.2017 në shumën prej 129.744,00€,

Kontrata e lidhur “ Meremetimi i rrugëve dhe trotoareve”, Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 573.735,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 17.07.2018, Loto i - 149.418.40€ Loto II - 87.765,00€, Loto III - 128.110,00€, shuma totale 365.293.40€.

Kontrata e lidhur “Ndërtimi i palestrës sportive në Komunën e Rahovecit” Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 896.327,50 €, sipas paramasës dhe parallogaris

të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 18.06.2018, në shumën prej 628.545,28€.

Kontrata e lidhur "Riparimi i Objekteve Shëndetësore" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 44.360,14€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 08.08.2018, në shumën prej 31.452,68€.

Kontrata e lidhur "Mirëmbajtja e Ndriqimit Publik në Komunën e Rahovecit" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 285.000,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 26.09.2018, në shumën prej 176.086,10€.

Kontrata e lidhur "Ulja e niveletës së proit në fshatin celinë" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 217.000,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 06.09.2018, në shumën prej 128.526,00€.

Kontrata e lidhur "Furnizimi me dru, thenxhuill dhe pelet për nevojat e Komunës së Rahovecit" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 395.000,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 17.09.2018, në shumën prej 324.864,00€.

Kontrata e lidhur "Ndërtimi i objektit të qerdhës së fëmijëve në fshatin Ratkoc" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 631.033,37€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 20.11.2018, në shumën prej 468.292,23€.

Kontrata e lidhur "Ndërtimi i SHMFU "Herojt e Kosovës" në Hoqë të Vogël – Brestoc" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 880.450,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 26.11.2018, në shumën prej 464.298,82€.

Kontrata e lidhur "Kullimi i tokave Bujqësore në Xërxe" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 266.000,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 02.11.2018, në shumën prej 148.325,14€.

Kontrata e lidhur "Ndërtimi i Rrugëve në Komunën e Rahovecit" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 368.833,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 03.12.2018, në shumën prej 271.388,20€.

Kontrata e lidhur "Rregullimi i shtretërve të lumejve dhe Përockave në Komunën e Rahovecit" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 1.106.897,24€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 06.12.2018, në shumën prej 765.095,30€.

Kontrata e lidhur "Ndërtimi i Kanalizimit në Komunën e Rahovecit" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 497.896,00€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 03.12.2018, në shumën prej 441.155,89€.

Kontrata e lidhur "Riparimi i Objekteve Shëndetësore" Deklerata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerisë së fondeve ishte në vlerë 44.360,14€, sipas paramasës dhe parallogaris të parashikuar, kontrata ishte e lidhur me 08.08.2018, në shumën prej 31.452,68€, dhe Aneks kontrata e nënshkruar nga menagjeri i prokurimit në shumën prej 3.038,00€.

Të gjitha paramasat dhe parallogarit e parashikuara janë të përpiluara me çmime të larta, pa datë, dhe pa nënshkrim të përpiluesit.

KONKLuzioni

Mungesa e verifikimit të çmimeve në tregë ndikon në rritjen e shumave në paramas dhe parallogari të parashikuar dhe dakordimi i tyre me sasi të kontraktuara, rrisin rrezikun e tejkalimit të pozicioneve të

parapara në kontratë.

3.2. Shpenzimi i paras publike a është bërë për nevoja të Komunës në mënyrë transparente, të besueshme dhe të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke konsistuar në dhënjen e kontratave publike me operator po ashtu të përgjegjshme, ekonomik dhe sipas parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit.

Projektet janë mënyrë e veçant e zhvillimit dhe formë e rëndësishme për realizimin e qëllimeve të definuara në planet zhvillimore të vendit, lokalitetit, kompanisë.

Projektet sigurojnë shfrytëzimin racional të fondeve dhe resurseve të rralla, i kontribuojnë rritjes së të ardhurave, qëndrueshmërisë ekonomike, si dhe cilësisë më të mirë të jetesës përgjithësisht. Plotësimi i këtyre objektivave kryesorë varët se në çfarë shkalle përmbushën parametrat e planifikuar të projektit. Një projekt është një detyrë unike, e përkohshme, komplekse dhe me qëllim të caktuar, me përshkrim të sakta të detyrave dhe resurse të definuara.

Çështja 6 - Mos kryerja e projekteve niveli i lartë i obligimeve të pa paguara

Të Gjeturat

Ishin 38 projekte të planifikuara, prej tyre ishin 31 projekte në vazhdim të viteve paraprake.

7 projekte ishin të vitit 2018, (4 kontrata ishin të lidhura kurse 3 kontrata ishin në procedur të inicimit), 16 projekte ishin të përfunduara.

Projektet e pa përfunduara ishin 15 që nga viti 2012 e gjërë në vitin 2017, e që është

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në vlerë prej 2.243.767,00€, ishin në fund të vitit 2017. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Kjo vlerë e obligimeve të papaguara është rezultat i kontroleve të brendshme të pamjaftueshme dhe hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Komuna nuk ka menaxhuar si duhet obligimet ndaj furnitorëve. Obligimet e papaguara datojnë që nga vitet paraprake dhe vitet pasuese. Ato nuk janë paguar për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet e mjaftueshme buxhetore. Gjithashtu janë evidentuar edhe vonesa në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve. Sipas Rregullës Financiare 01-2013, MF- Shpenzimi i parave publike Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Sipas raportit të shpenzimeve të pa paguara gjërë në fund të muajit shtator të vitit 2018, kanë mbetur obligimet të pa paguara në shumën prej 99.147,17€.

KONKLUSIONI

Projektet jo të kryera është në kundërshtim me marrëveshjet, kalojnë përtej planifikimeve buxhetore dhe në mungesë të mjeteve, përcillen me implikime buxhetore për komunën e cila sfidohet me obligime të shumta pa mbështetje financiare me ndikim në vonesa të realizimit të projekteve.

Shpenzimi i paras publike a është bërë për nevoja të Komunës në mënyrë transparente, të besueshme dhe të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke konsistuar në dhënjen e kontratave publike me operator po ashtu të përgjegjshme, ekonomik dhe sipas parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit

3.3. Vlerësimi i rrezikut dhe identifikimi i rrezikut sipas rregullave të MFK-së

Entiteti i audituar është pritur të dizajnoj kontrollin e brendshëm në zbatimin e procesit të objektivave, procesin e vlerësimit të rrezikut, identifikimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut mbështetur në rregullat dhe procedurat që rrjedhin nga MFK-ja e obligojnë Entitetin të hartojnë regjistrin e rrezikut i dokumentuar dhe i kompletuar për një menaxhim efektiv operacional dhe strategjik në menaxhimin administrativ dhe financiar të sistemit.

Çështja 7 - Mos zbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut- prioritet i lartë.

Te gjeturat:

Zyrtari përgjegjës për prokurim në komunë bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve nuk ka projektuar dhe hartuar një proces në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut , vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në formë të dokumentuar dhe të shkruar , dhe një regjistri të objektivave specifike (5 (pesë) më shumë se 10 (dhjetë) dhe të riskut me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara.

KONKLUSIONI

Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë performancën e sistemit të vlerës për para për mesë realizimit të projekteve kapitale si dhe do të dëmtoj cilësinë Infrastrukturës (projektet investive) .

Rekomandimet:

REKOMANDIMI - 1

- Rekomandojm që zyra e prokurimit të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit të bëhet në pajtueshmëri me planifikimin aktual të prokurimit.

REKOMANDIMI - 2

- Rekomandojm Zyrën e Prokurimit, të siguroj se projektet janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat e ligjit të ndërtimit, me ç'rast fillimisht sigurohet leja ndërtimore, mbikëqyrja inspektive gjatë ekzekutimit dhe në fund të projektit të sigurohet leja e përdorimit.

REKOMANDIMI - 3

- Rekomandojm që zyra e prokurimit, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e nevojshme dhe bërë zotimin e plotë para lidhjes së kontratës për realizimin e saj.

REKOMANDIMI - 4

- Rekomandojm që Zyra e Prokurimit, duhet të sigurojë se gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit komisionet përkatëse formohen prej rastit në rast me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ, në përputhje me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik

REKOMANDIMI - 5

- Rekomandojm që në paramas dhe parallogari të parashikuar të vendosën çmimet sipas konkurrencës në treg.

REKOMANDIMI – 6

- Rekomandojmë që Drejtoria e audituar duhet të sigurojë se projektet të kryhen në përputhje të plotë me marrëveshjet e bëra me palët e ndërlidhura me qëllim të evitimit të implikimeve financiare që shkaktohen më tej gjatë realizimit të tyre.

REKOMANDIMI – 7

- Rekomandojmë Zyrtari përgjegjës i prokurimit me pranimin e përgjegjësive të deleguara nga ZKA-ja për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vijim duhet të sigurojnë zbatimin e kërkesave për këtë sistem dhe të sigurojnë forcimin e kontrollit që rreziqet të jenë nën kontroll.

Përshkrimi i shkurt i drejtimit (përshkruaj objektivat dhe fushëveprimin e auditimit):

2.1. Objektivat e auditimit

2. A është bërë zbatimi i procedurave prej inicimit të aktivitetit të prokurimit e deri tek përmbarimi i kontratës publike, në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit të prokurimit public.
3. Shpenzimi i paras publike a është bërë për nevoja të Komunës në mënyrë transparente, të besueshme dhe të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi si dhe duke konsistuar në dhënjën e kontratave publike me operator po ashtu të përgjegjshme, ekonomik dhe sipas parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit.

1.2. Fushëveprimi i auditimit

- Menaxhimi lidhur me zbatimin e procedurave të prokurimit për llojet e kontratave për furnizim, punë, koncesion, projektim, dhe shërbime të konsulencës për periudhën 01.01.2018-30.11.2018
- Lokacioni: Zyra e prokurimit

2. Rastet e moszbatimit ose zbatimit të gabuar të ligjit dhe dispozitave tjera ligjore, dhe dyshimeve për mashtrim

2.1 Thekso shkurtimisht rastet e mos përmbajtjes ose zbatimit të gabuar të ligjeve dhe dispozitave tjera dhe dyshimit të mashtrimit të vërtetuara gjatë kryerjes së auditimit:

3. Aktivitetet të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të rëndësishme, si dhe moszbatimin e rekomandimeve të rëndësishme

3.1 Shkurtimisht thekso aktivitetet e rëndësishme të cilat i ka ndërmarrë Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik me qëllim të zbatimit të rekomandimeve nga raportet e auditimit:

3.2 Shkurtimisht përshkruaj rekomandimet e rëndësishme nga raportet e auditimit të cilat nuk janë zbatuar:

4. Përfundimet kryesore të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit financiar dhe të kontrollit, si dhe rekomandimet e dhëna me qëllim të përmirësimit të afarizmit të subjektit të sektorit publik
5. Propozimet për zhvillimin e auditimit të brendshëm
5.1 Theksoni shkurtimisht aktivitetet të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në subjektin tuaj të sektorit publik:
5.2 Propozimet e juaja për zhvillim dhe përparim të auditimit të brendshëm (në përgjithësi)

Nënshkrimi i udhëheqësit të NjAB

